**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK**

# DOKUMENTAT STANDARDE TË PROCEDURËS SË HAPUR MALLRA [1]

## UNIFORMA DHE VESHJE TË TJERA SPECIALE PËR POLICINË BASHKIAKE

**BASHKIA TIRANË**
**2020**

REF-69154-08-19-2020

## I NJOFTIMI I KONTRATËS

**Seksioni 1. Autoriteti Kontraktor**

**1.1 Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor**

| | |
|---|---|
| Emri | Bashkia e Tiranës |
| Adresa | Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" |
| Tel/Fax | 00 355 4 22 56 799 |
| E-mail | administrative.prokurime@tirana.al |
| Faqja e Internetit | www.tirana.al |

**1.2 Lloji i autoritetit kontraktor:**

Institucion qëndror     Institucion i pavarur

Njesi e qeverisjes vendore **X**     Tjetër

**1.3 Kontratë në kuadrin e një Marrëveshjeje të veçantë ndërmjet Shqipërisë dhe një Shteti tjetër**

Po     Jo **X**

**Seksioni 2. Objekti i kontratës: "Uniforma dhe veshje të tjera speciale për Policinë Bashkiake"**

**2.1 Numri i referencës së procedurës/lotit** REF-69154-08-19-2020

**2.2 Lloji i "Kontratave Publike për Mallra"**

Blerje **X**     Qira     Leasing     Blerje me këste     Një kombinim i tyre

**2.3 Kontratë në bazë të Marrëveshjes Kuadër**

Po     Jo **X**

**2. 4 Lloji i Marreveshjes Kuadër**

**Me një Operator Ekonomik**

**Me disa operatorë ekonomikë**

**Të gjitha kushtet janë të përcaktuara** Po     Jo

**Në Marrëveshjen Kuadër me 1 Operator Ekonomik, kur të gjitha kushtet janë të përcaktuara, të jepen arsyet e përzgjedhjes së kësaj lloj Marrëveshje Kuadër.**

| |
|---|
| |

**2.5 Numri i operatorëve ekonomikë me të cilët do të perfundojë Marrëveshja Kuadër:___________**(*Këtu duhet të përcaktohet numri maksimal i operatorëve ekonomikë me të cilët do të lidhet Marrëveshja Kuadër*).

| | | |
|---|---|---|
| **2. 6** | Kushtet që do zbatohen në rastin e rihapjes së konkurimit dhe/ose përdorimi i mundshëm i blerjes elektronike . | |

**2. 7 Autoriteti kontraktor/Autoritetet kontraktore të cilat do të lidhin marrëveshjen kuadër: ________________________________________________________________**

**________________________________________________________________________**

**2.8 Përshkrim i shkurtër i kontratës/marrëveshjes kuadër**

1. Fondi limit/Vlera e pritshme e kontratës: 13,333,300 (trembëdhjetë milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind)
2. Në rastin kur objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj, **shumatorja e çmimeve për njësi është (Nuk është MK)**
3. Burimi i Financimit: vënë në dispozicion me anë të VKB-së Nr. 157, datë 26.12.2019 "Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2020-2022 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2020" (i ndryshuar).
4. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër**: "Uniforma dhe veshje të tjera speciale për Policinë Bashkiake"**

**2. 9 Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:**

Operatori ekonomik fitues duhet të lëvrojë mallin sipas kërkesave dhe specifikimeve të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor brenda 60 ditëve pune nga data e lidhjes së kontratës. Malli duhet të dorëzohet në magazinën e Bashkisë Tiranë.

2.9.1. Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër

| |
|---|
| **Kohëzgjatja në muaj:** *ose* **ditë: (nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër***(jo më shumë se (4) vjet*) |

*Ose* **duke filluar nga // (dd/mm/vvvv)**
**Përfunduar më // (dd/mm/vvvv)**

**2.10 Vendi i dorëzimit të objektit të kontratës/marrëveshjes kuadër:**
Magazina e Bashkisë Tiranë

**2.11 Ndarja në LOTE:**

Po Jo **X**

*Nëse po,*

**2.12 Përshkrim i shkurtër i loteve**
(Objekti dhe fondi limit i LOTEVE)
1_____________________________________________________________________2.___
________________________________________________________________3.________
____________________________________________________________etj

Një Ofertues mund të aplikojë për [një lot], [disa lote], [të gjitha lotet]. Për çdo lot paraqitet një ofertë e veçantë.

**2.13 Opsionet:**
Numri i rinovimeve të mundshme *(nëse ka)*: **(Nuk ka)**
Ose: nga në

**2.14 Do të pranohen variantet:**
Po Jo **X**

**2.14.1 Do të pranohet nenkontraktimi:**
Po Jo **X**

**Nese do te lejohet nenkontraktimi,** te specifikohet perqindja e lejuar per nenkontraktim: ____

Autoriteti kontraktor do t'i beje pagesa te drejperdrejte nenkontraktorit:

Po Jo

**Shenime te tjera**

______________________________________________________________________________
______________________________________________________________________________
________________________________________________________________

**2.15. Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë të Informacionit dhe Komunikimit (TIK) janë përdorur standartet e përgatitura nga Agjencia Kombëtare e Shoqerisë së Informacionit:**

Po Jo **X**

**2.16. Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë të Informacionit dhe Komunikimit (TIK), në rastin kur standardet janë të pa-aplikueshme, është marrë miratimi paraprak nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit:**

Po Jo **X**

**Seksioni 3 Informacioni ligjor, ekonomik, financiar dhe teknik**

**3.1 Kriteret e Pranimit** sipas shtojcës 9.

**3.2 Sigurimi i Ofertës[1]:** (i zbatueshëm në rastin e procedurave të prokurimit me vlerë më të lartë se kufiri i lartë monetar, në rast se kërkohet nga autoriteti kontraktor).

Operatori Ekonomik paraqet Formularin e sigurimit të ofertës, kur kërkohet, sipas Shtojcës 4. Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës është _________ Lekë (shuma e shprehur në fjalë).

Në rastet e dorëzimit të ofertës për Lote, vlera e sigurimit të ofertës, kur kërkohet, për secilin nga Lotet është si më poshtë:

Loti 1 ______ Lekë
Loti 2 ______ Lekë

**Seksioni 4 Procedura**

**4.1 Lloji i procedurës:** E Hapur

Procedurë prokurimi e rishpallur

Po Jo **X**

Nëse është procedurë e rishpallur të plotësohen të dhënat identifikuese të procedurës së anuluar:

a) Numri i referencës në sistemin e prokurimit elektronik të procedurës së prokurimit të anulluar ____________________________________________________________

b) Objekti i prokurimit të procedurës së prokurimi të anulluar ___________________________
c)Fondi limit i procedurës së prokurimit të anulluar ___________________________________

**4.2 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:**

A) **çmimi më i ulët** X

Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, **çmimi më i ulët** bazohet në:

i) çmimi i bursës, sipas Reuters lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili është publikuar në Buletinin e fundit të Njoftimeve Publike, para datës së dorëzimit dhe hapjes së ofertave;
ii) elementet fiskale, përfshi akcizën, taksë karboni si dhe çdo taksë tjetër sipas legjislacionit në fuqi;
iii) marzhi më i ulët i fitimit, të shprehur në përqindje.

*Vlera absolute e marzhit të fitimit nuk do të ndryshojë gjatë ekzekutimit të kontratës, në rast të luhatjes se çmimeve.*

*Ose*

B) **oferta ekonomikisht më e favorshme**

lidhur me rëndësinë: Çmimi **pikë**

etj. **pikë**

Autoriteti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për çdo kriter vlerësimi të vendosur.

**4.3 Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:**

Data: **14/09/2020** *(dd/mm/vvvv)* **Ora: 12:00**

Vendi: Bashkia Tiranë, www.app.gov.al

**Kur oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike operatorët ekonomike duhet të dorëzojnë ofertën në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP-së, www.app.gov.al**

**4.4 Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:**

Data: **14/09/2020** *(dd/mm/vvvv)* **Ora: 12:00**

Vendi: Bashkia Tiranë, www.app.gov.al

**Informacioni mbi ofertat e paraqitura me mjete elektronike duhet t'i komunikohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë dorëzuar oferta, në bazë të kërkesës së tyre.**

**4.5 Periudha e vlefshmërisë së ofertave: 150 (njëqind e pesëdhjetë) ditë**

**4.6 Gjuha (-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:**

Dokumentat Standarde të Tenderit

Shqip **X** Anglisht

Tjetër _______________

**Seksioni 5 Informacione plotësuese**

**5.1 Dokumenta me pagesë** *(i zbatueshëm vetëm për procedurat që nuk zhvillohen me mjete elektronike):*

Po Jo **X**

*Nëse Po*

Monedha _________ Çmimi _______

Ky çmim mbulon kostot aktuale të kopjimit dhe shpërndarjes së DT tek Operatorët Ekonomikë. Operatorët Ekonomikë të interesuar kanë të drejtë të kontrollojnë DT para blerjes së tyre.

**5.2 Informacione shtesë (vendi, zyra, mënyrat për tërheqjen e dokumentave të tenderit)**

___________________________________________________________________________

___________________________________________________________________________

_____________________________________________________________

Data e shpërndarjes së këtij njoftimi **20/08/2020**

**Njoftimi i kontrates për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor, i cili do të publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike**

**1. Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor**

| | |
|---|---|
| Emri | Bashkia e Tiranës |
| Adresa | Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" |
| Tel/Fax | 00 355 4 22 56 799 |
| E-mail | administrative.prokurime@tirana.al |
| Faqja e Internetit | www.tirana.al |

**2. Lloji i procedurës se prokurimit: "Procedurë e hapur"**

**3.Numri i referencës së procedurës/lotit:** REF-69154-08-19-2020

**4. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër: "Uniforma dhe veshje të tjera speciale për Policinë Bashkiake".**

**5. Fondi limit**: **13,333,300 (trembëdhjetë milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind).**

**6. Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin**: 60 (gjashtëdhjetë) ditë pune nga data e lidhjes së kontratës.

**7. Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: data 14/09/2020, Ora 12:00**

**8. Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: data 14/09/2020, Ora 12:00**

## II. UDHËZIME PËR OPERATORËT EKONOMIKË

**Seksioni 1. <u>Hartimi i ofertës</u>**

1.1 Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme.

1.2 Operatori Ekonomik përballon kostot që lidhen me përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës së tij. Autoriteti Kontraktor nuk është përgjegjës për këto kosto.

1.3 Për procedurat e prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, origjinali i ofertes duhet të shtypet ose të shkruhet me bojë që nuk fshihet. Të gjitha fletët e ofertës duhet të lidhen së bashku dhe të numerizohen. Të gjitha fletët e ofertës, përveç literaturës së pandryshueshme e të printuar duhet të pajisen me iniciale ose të nënshkruhen nga Personi (-at) e autorizuar. Çdo ndryshim në ofertë duhet të jetë i lexueshëm dhe i firmosur nga Personat e Autorizuar.

1.4 Në rast të ofertave të paraqitura nga një bashkim operatorësh ekonomik, oferta duhet të shoqërohet me Prokurën/autorizimin me Shkrim për Personat e Autorizuar që do të përfaqësojnë bashkimin gjatë procedurës së prokurimit

1.5 Operatori ekonomik, mban përgjegjësi për të gjithë dokumentacionin e paraqitur si pjesë e ofertës. Në rast verifikimi të përmbajtjes së dokumentacionit të paraqitur, apo të vetëdeklarimeve, kur përmbajtja e tyre nuk rezulton e vërtetë, operatori ekonomik ndodhet në kushtet e parashikuara në nenin 13, pika 3, gërma (a) të LPP-së.

1.6 **Oferta duhet të përfshijë dokumentat e mëposhtëm:**

a) Formulari i Ofertës, plotësuar sipas Shtojcës 1 të DT ose Shtojcës 2 të DT (në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje).

b) Dokumentat që lidhen me objektin e prokurimit (*skica, katalogje, kampione etj*)
___________ ,
___________ ,
___________ .

c) Deklaratën për paraqitje oferte të pavarur sipas shtojcës 2/1.

ç) Dokumentat dhe vërtetimet e kërkuara në Shtojcën 8.

d) (Opsion) ofertën alternative teknike (nëse parashikohet)

Një Operator Ekonomik duhet të paraqesë vetëm një ofertë.

Me plotesimin e Shtojcës "Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së Dispozitave Ligjore në Marrëdhëniet e Punës", operatori ekonomik pranon se ka kontrata pune me çdo punëmarrës dhe që respekton të drejtat e punëmarrësve, sipas dispozitave të Kodit të Punës (ku përfshihen edhe të drejtat e gruas shtatzënë, gruas që sapo ka lindur dhe/ose gruas me fëmijë në gji, të parashikuara në nenet 104, 105, 105/a, 106, 108 dhe 115, dhe të legjislacionin të punës në

tërësi.

1.7 Fshehtësia e procesit sipas nenit 25 të LPP-së.

1.8 Për procedurat e prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, Operatorët Ekonomikë duhet të dorëzojnë vetëm ofertën origjinale të futur në një zarf jotransparent, të mbyllur, të vulosur dhe firmosur me emrin dhe adresën e Ofertuesit dhe të shënuar: "Ofertë për furnizimin e mallrave; Nr e Njoftimit _.
**"MOS E HAPNI, ME PËRJASHTIM TË RASTEVE KUR ËSHTË I PRANISHËN KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTËS, DHE JO PARA dd/mm/vv __________ orës _________"**

**Kur oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike, operatorët ekonomike duhet të dorëzojnë ofertën në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP-së, www.app.gov.al.**

1.9 Për procedurat e prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, ofertuesit mund të modifikojnë ose të tërheqin ofertat e tyre, me kusht që ky modifikim ose tërheqje të kryhet para afatit kohor përfundimtar për paraqitjen e ofertave. Si modifikimet, ashtu edhe tërheqjet duhet t'i komunikohen Autoritetit Kontraktor me shkrim para datës së fundit për dorëzimin e ofertave. Zarfi që përmban deklaratën e Ofertuesit duhet të shënohet përkatësisht: **"MODIFIKIM OFERTE"** ose **"TËRHEQJE OFERTE".**

**Kur oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike, ofertuesi mund te modifikojë në çdo kohë ofertën deri përpara përfundimit të afatit kohor për dorëzimin e ofertave, pa patur nevojë për ndonjë komunikim me autoritetin kontraktor, pasi veprimet kryhen në llogarinë e tij, në faqen zyrtare të APP-së, www.app.gov.al.**

**Seksioni 2 <u>Përllogaritja e ofertës ekonomike</u>**

2.1 Operatori Ekonomik duhet të plotësojë Formularin e Ofertës bashkangjitur me këto DT, duke përcaktuar mallrat që do të levrohen, sasitë dhe çmimin e tyre.

2.2 Të gjitha çmimet duhet të kuotohen në Monedhën Shqiptare (Lek), duke përfshirë edhe tatimet që zbatohen, por pa përfshirë TVSH. Nëse çmimet kuotohen në një monedhë të huaj, atëherë ato duhet të kthehen në Lekë Shqiptare sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, në datën në të cilën është dërguar për publikim njoftimi i kontratës dhe duhet të ruhen në atë kurs deri në skadimin e periudhës së vlefshmërisë së ofertës.

2.3 Ofertuesi duhet të shënojë në Formularin e Ofertës, çmimet totale të ofertës të të gjitha Mallrave, pa TVSH. Vlera e TVSH, kur aplikohet, i shtohet çmimit të dhënë dhe përbën vlerën totale të ofertës.

2.4. Në rastin e nje marrëveshje kuadër ku të gjitha kushtet NUK janë përcaktuar, çmimet për kontratat e bazuara në marrëveshjen kuadër nuk janë të fiksuara; ato janë objekt i ndryshimit pas një mini-konkursi midis operatorëve ekonomikë, palë në marreveshjen kuadër.

2.5 Sigurimi i Ofertës, kur kërkohet, duhet të dorëzohet bashkë me ofertën para skadimit të afatit

kohor për dorëzimin e ofertave. Mospajtimi me kërkesat për sigurimin e ofertës do të ketë si pasojë refuzimin e ofertës.

2.6 Sigurimi i Ofertës mund të dorëzohet në një nga format e mëposhtme:

a) garanci bankare
b) garanci sigurimi

Formulari i sigurimit të ofertës duhet të nënshkruhet nga lëshuesi (Banka, kompania e sigurimit, etj) dhe duhet të dorëzohet së bashku me ofertën para hapjes së ofertave, përndryshe oferta do të refuzohet.

Dokumentat si më sipër duhet të jenë të vlefshëm përgjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së ofertës. Në rastin kur sigurimi i ofertës ka formën e një garancie bankare, Autoriteti Kontraktor ia rikthen ofertuesve sigurimin përkatës brenda 15 ditëve nga nënshkrimi i kontratës.

2.7 **Periudha e Vlefshmërisë së Ofertës**

Periudha e vlefshmërisë së ofertës fillon që nga momenti i hapjes së ofertave. Në çdo rast, të paktën 5 ditë nga përpara përfundimit të afatit kohor për vlefshëmrinë e ofertave, autoriteti kontraktor mund t'i kërkojë Ofertuesit me shkrim të zgjasë periudhën e vlefshmërisë, deri në një datë të caktuar. Ofertuesi mund t'a refuzojë këtë kërkesë me shkrim pa humbur të drejtën për rimbursim të sigurimit të ofertës, kur ka një tillë. Ofertuesi që bie dakord të zgjasë periudhën e vlefshmërisë së ofertës njofton Autoritetin Kontraktor me shkrim, dhe paraqet një sigurim oferte të zgjatur, nëse ka pasur një të tillë. Oferta nuk mund të modifikohet. Nëse Ofertuesi nuk i përgjigjet kërkesës së bërë nga Autoriteti Kontraktor lidhur me zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së ofertës, ose nuk e pranon kërkesën në fjalë, ose nuk paraqet një sigurim të zgjatur të ofertës, kur kërkohet, atëherë Autoriteti Kontraktor do të refuzojë ofertën.

2.8 Veprimet e jashtëligjshme sipas Nenit 26 të LPP-së

**Seksioni 3. Vlerësimi i Ofertave**

**3.1 Kriteret e përzgjedhjes**

**(Opsioni 1)** Çmimi më i ulët i ofertës së kualifikuar.

Kontrata do t'i akordohet atij Ofertuesi që ka ofruar çmimin më ulët të ofertës.

Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, **çmimi më i ulët** bazohet në:

i) çmimi i bursës, sipas Reuters lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili është publikuar në Buletinin e fundit të Njoftimeve Publike, para datës së dorëzimit dhe hapjes së ofertave;
ii) elementet fiskale, përfshi akcizën, taksë karboni si dhe çdo taksë tjetër sipas legjislacionit në fuqi;
iii) marzhi më i ulët i fitimit, të shprehur në përqindje.

*Vlera absolute e marzhit të fitimit nuk do të ndryshojë gjatë ekzekutimit të kontratës, në rast të luhatjes se çmimeve.*

**(Opsioni 2)** Oferta ekonomikisht më e favorshme.

Për kriteret vlerësuese duhet përcaktuar qartë pesha specifike e secilit kriter dmth sa pikë do të ketë çdo kriter dhe si do të llogariten pikët për ofertuesit e njëpasnjëshëm.

Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të cmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100.

Formula me të cilën do të llogariten pikët e ofertuesve në këtë rast është:

Po= Pk1+Pk2+Pk3+.....

Ku:
Po - jane pikët totale të ofertës së vlerësuar
Pk1/Pk2/Pk3/... - jane pikët për çdo kriter të vlerësuar

Pikët për çdo kriter përllogariten sipas formulës:

Pk1= Vmink1 x Pmaxk1/Ok1

| | |
|---|---|
| Pk1 _____ | Pikët e kriterit që vlerësohet |
| Vmin k1 | Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet |
| Pmaxk1 | Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet |
| Ok1 | Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet |

**Sqarim**: Si kriter vlerësimi duhet të përzgjidhet vetëm njëri prej opsioneve. Plotësimi i të dy opsioneve e bën procedurën të pavlefshme.

### 3.2 Korrigjimi i gabimeve dhe pjesët e hequra

3.2.1 Autoriteti Kontraktor korrigjon ato gabime në ofertë, që janë thjesht të një natyre aritmetike, nëse gabimi zbulohet gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti Kontraktor e njofton menjëherë Ofertuesin në fjalë me një njoftim me shkrim/elektronik mbi çdo korrigjim të tillë dhe mund të vazhdojë me ndryshimin e gabimit, me kusht që Ofertuesi t'a ketë miratuar këtë komunikim që i është bërë. Nëse Ofertuesi refuzon të pranojë korrigjimin e propozuar, atëherë oferta do të

refuzohet, pa konfiskim të sigurimit të ofertës, nëse ekziston një e tillë.

3.2.2 Gabimet në llogaritjen e çmimit do të korrigjohen nga Autoriteti Kontraktor, si më mëposhtë:

- në rast se ka mospërputhje ndërmjet shumave të shprehura në shifra dhe atyre në fjalë, atëherë do të mbizotërojnë shumat e shprehura në fjalë, me përjashtim të rasteve kur shuma në fjalë lidhet me një gabim aritmetik;

- nëse ka mospërputhje ndërmjet çmimit njësi dhe vlerës së përgjithshme që merret nga shumëzimi i çmimit njësi dhe sasisë, atëherë do të mbizotërojë çmimi njësi, dhe rrjedhimisht duhet të korrigjohet shuma në total, nëse ka një gabim në një shumë total, që korrespondon me mbledhjen ose zbritjen e nëntotaleve, atëherë do të mbizotërojë nëntotali dhe totali duhet të korrigjohet. Shumat e korrigjuara në këtë mënyrë janë të detyrueshme për ofertuesin. Nëse ofertuesi nuk i pranon ato, atëherë oferta e tij do të refuzohet *Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumat absolute të të gjitha korrigjimeve* janë më shumë se ± 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar

## 3.3 Ofertat anomalisht të ulëta

3.3.1 Nëse oferta e dorëzuar, rezulton anomalisht e ulët në lidhje me mallrat e ofruara, atëherë Autoriteti Kontraktor i kërkon Ofertuesit në fjalë të justifikojë çmimin e ofruar. Nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim që të bindë Autoritetin Kontraktor, atëherë ky i fundit ka të drejtë të refuzojë ofertën.

3.3.2 Oferta do të cilësohet anomalisht e ulët sipas përcaktimit të bërë në nenin 66 të Kreut VII të RrPP .

Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25 përqind e fondit limit të përllogaritur.

Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85 përqind e mesatares së ofertave të vlefshme.

Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP.

Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe dokumentojë me prova shkresore sqarimet mbi elementin/elementët e veçantë të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP.

Formula që do të zbatohet për të cilësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ka tre ose më shumë oferta të vlefshme është si më poshtë:

O – Oferta
$M_O$ – Mesatarja e Ofertave të vlefshme

n – Numri i Ofertave të vlefshme
$Z_M$ – Zbritja e Mundshme

$$\mathbf{M_O = O_1 + O_2 + O_3 + \ldots O_n / n}$$

$$\mathbf{Z_M = 85\ \%\ Mo}$$

**Vlera e Ofertës që vlerësohet <ZM.......... , si rrjedhim Oferta është Anomalisht e Ulët**

Në rastin kur kriter vlerësimi është përzgjedhur oferta ekonomikisht më e favorshme, do të verifikohet nëse ofertat janë anomalisht të ulëta vetëm nëse oferta e klasifikuar me pikët më të larta e ka ofertën ekonomike me vlerën më të ulët.

**3.4.** Ankimi administrativ në dispozicion të Operatorëve Ekonomikë sipas nenit 63 të LPP-së.

## Seksioni 4. Nënshkrimi i Kontratës

### 4.1 Njoftimi i fituesit

Autoriteti Kontraktor njofton Ofertuesin fitues, përmes dërgimit të njoftimit të fituesit, siç parashikohet në Shtojcën 14. Një kopje e këtij njoftimi publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike, siç kërkohet në Nenin 58 të LPP-së.

### 4.2 Sigurimi i kontratës

4.2.1 Autoriteti Kontraktor kërkon sigurim për ekzekutimin e kontratës. Shuma e sigurimit për ekzekutimin e kontratës do të jetë 10 % e vlerës së kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, sipas Shtojcës 19 të DT, duhet të nënshkruhet dhe të dorëzohet para nënshkrimit të kontratës.

4.2.2 Sigurimi për ekzekutimin e kontratës mund të dorëzohet në një nga format e mëposhtme:
i. garanci bankare
ii. garanci sigurimi

**Ky formular nuk përdoret nga autoritetet kontraktore në rastin e prokurimit të kontratave sektoriale.**

### 4.3 Njoftimi i kontratës së nënshkruar

Në pajtim me RrPP, pas nënshkrimit të kontratës, autoriteti kontraktor dërgon një njoftim në APP për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike.

**Shënim**: Autoritetet kontraktore nuk duhet të ndërhyjnë për të bërë asnjë lloj ndryshimi në dokumentat

e tenderit nga pika 1 në pikën 4.

## III. SHTOJCAT

Shtojcat e mëposhtme janë pjesë përbërëse e DT:

Shtojca 1: Formulari i Ofertës ekonomike
Shtojca 2: Formulari i Ofertës ekonomike, në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje
Shtojca 2/1: Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur
Shtojca 3: Ftesa për Ofertë në rastin e Marrëveshjes Kuadër
Shtojca 4: Formulari i Sigurimit të Ofertës
Shtojca 5: Formulari i Informacionit Konfidencial
Shtojca 6: Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike nga operatori ekonomik
Shtojca 7: Deklarata për konfliktin e interesit
Shtojca 8: Deklaratë mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme
Shtojca 8/1: Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave Ligjore në marëdhëniet e punës
Shtojca 9: Formular për Vërtetimin e Kualifikimit/pjesëmarrjes
Shtojca 10: Specifikimet teknike
Shtojca 11: Planifikimi i kontratave në marrëveshjen kuadër
Shtojca 12: Sasia e mallrave dhe kushtet e lëvrimit
Shtojca 13: Formulari për Njoftimin S'kualifikimit
Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Fituesit
Shtojca 15 Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomike të suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër
Shtojca 16: Kushtet e Përgjithshme të Kontratës
Shtojca 17: Kushtet e Vecanta të Kontratës
Shtojca 18: Formulari i njoftimit të Kontratës së nënshkruar
Shtojca 18/1: Formulari i njoftimit të Kontratës së nënshkruar për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike
Shtojca 19: Formulari i Sigurimit të Kontratës
Shtojca 20: Formulari i Ankesës në Autoritetin Kontraktor
Shtojca 21: Draft Marrëveshja Kuadër ku Jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara
Shtojca 22: Draft Marrëveshja Kuadër ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara
Shtojca 23: Formulari i Njoftimit të Anulimit

**Shtojca 1**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik*]

## FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE

Emri i Ofertuesit____________________

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*

* * *

Procedura e prokurimit: *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]/Nr.Referencës në faqen e APP-së*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. Çmimi total i ofertës sonë është [*monedha dhe vlera e ofertës*]; pa TVSH;
2. Çmimi total i ofertës sonë është [*monedha dhe vlera e ofertës*]; me TVSH

| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Nr** | **Përshkrimi i mallrave** | **Njësia** | **Sasia** | **Çmimi Njësi** | **Çmimi Total** | **Afati** |
| 1 | Këmishë me mëngë të gjata | Copë | 1100 | | | brenda 60 ditëve pune nga data e lidhjes së kontratës |
| 2 | Këmishë me mëngë të shkurtëra | Copë | 1100 | | | |
| 3 | Këpucë gjysma, lëkurë | Palë | 500 | | | |
| 4 | Këpucë lëkure, me qafa, trupe | Palë | 250 | | | |
| 5 | Kostum dok – trikoton (1 xhaketë, 2 palë pantallona, 2 copë kapela) | Komplet | 250 | | | |
| 6 | Kostum teritali: (1 xhaketë, 2 palë pantallona, 2 copë kapele) | Komplet | 200 | | | |
| 7 | Kravatë perhure sintetike | Copë | 351 | | | |
| 8 | Pantallona teritali, vere. | Copë | 497 | | | |
| 9 | Pulovër (lesh + akrilik) | Copë | 300 | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 10 | Rrip pantalloni, lëkurë e zezë | Copë | 180 | | | |
| 11 | Xhup operacional | Copë | 250 | | | |
| 12 | Rrip mesi sintetik, shërbimi – multifunksional | Komplet | 130 | | | |
| 13 | Spaleta (dok i plastifikuar) | Palë | 501 | | | |
| 14 | Xhup sintetik, kundra shiut. (Xhakavento) | Copë | 250 | | | |
| 15 | Pelerina shiu | Copë | 50 | | | |
| **Çmimi Neto** | | | | | | |
| **TVSH (20 %)** | | | | | | |
| **Çmimi Total** | | | | | | |

Nënshkrimi i ofertuesit ______________

Vula ______________

Shënim: Çmimet duhet të shprehen në Monedhën ____( kërkuar në dokumentat e tenderit )

**Shtojca 2**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant per ngrohje*]

**FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE**

Emri i Ofertuesit____________________

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*

* * *

Procedura e prokurimit: *[lloji i procedurës]*
Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[ objekti]*
Publikimi *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. Marzhi ynë i fitimit i shprehur në përqindje është si më poshtë:

| 1 | 2 | 3 | 5 |
|---|---|---|---|
| **Nr** | **Përshkrimi i mallrave** | **Marzhi i fitimit i shprehur në perqindje** | **Afati i levrimit** |
| | | | |
| | | | |

**Nënshkrimi i ofertuesit ______________**

**Vula ______________**

**Shtojca 2/1**

[*Shtojcë për t'u plotesuar nga Operatori Ekonomik*]

**DEKLARATË**

**<u>Për paraqitje Oferte të Pavarur</u>**

E operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë:_________________; nga Autoriteti Kontraktor: __________________; me objekt: ______________________; me fond limit: __________________.

Unë i nënshkruari _____________________, me cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik__________________, në mbështetje të nenit 1 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklarim dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

Unë vërtetoj, në interes të:___________________________që:
(Emri i operatorit ekonomik)

1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;

2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimet publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;

3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;

4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës,është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;

5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:

   a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
   b) është një ofertues potencial, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):

   a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;

   b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet

bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).

7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:

   a) çmimet ;
   b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
   c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
   d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).

9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

________________________________________________________
(Emri dhe Firma e Personit të Autorizuar për Përfaqësim të Ofertuesit)

__________________ ________________________
(Titulli sipas pozicionit në punë) (Data)

**Shtojca 3**

[ *Shtojcë për tu plotësuar nga autoriteti kontraktor në Marrëveshjen Kuadër gjatë rihapjes së procesit*

*të mini-konkursit]*

**FTESA PËR OFERTË**

(*shkruani emrin e Autoritetit Kontraktor*)
fton për të paraqitur oferta në procedurën për furnizimin e mallrave të mëposhtme:
……………………………………………………………………………………………………
……………………………………………………………………………………………………
………………………………………………………………………………………
(*jepni një përshkrim të saktë të objektit të kontratës dhe sasisë siç përkufizohet në Dokumentat e Tenderit (DT)*.

Vendi i Dorëzimit të Mallit
*(jepni nje pershkrim te shkurter)*

Malli duhet të dorëzohet brenda datës ____________

Oferta duhet të paraqitet
………………………………………………………………………………………………[*Jep adresën e saktë*]
Përpara
……………………………………………………………………………………………
[*Përcaktoni datën dhe orën*]
Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese ________________________________________

Forma e komunikimit:

Me shkrim elektronike (email, fax, etj)

**Shtojca 4.**

[*Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*]

[ *Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik kur kërkohet nga autoriteti kontraktor*]

**FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS**

*[Data]*

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]/Nr.Referencës në faqen e APP-se*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [*emri i ofertuesit të siguruar*] ka derdhur një depozitë pranë [*emri dhe adresa e bankës / kompanisë së sigurimit*] me një vlerë prej [*monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra*] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [*emri i autoritetit kontraktor*] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit perfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [*njoftimin e kontratës ose ftesën për tender*].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

**Shtojca 5**

**LISTA E INFORMACIONIT KONFIDENCIAL**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti*]

(Shënoni më poshtë informacionin që dëshironi të mbahet konfidencial)

| Lloji, natyra e informacionit që duhet të mbetet konfidencial | Numri i faqes dhe pikat e DT që dëshironi të mbeten konfidenciale | Arsyet pse ky informacion duhet të mbetet konfidencial | Afati kohor që ky informacion të mbetet konfidencial |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |

**KUJDES**

Çdo e dhënë, që nuk është regjstruar si e dhënë konfidenciale, do të konsiderohet se titullari i këtyre të drejtave ka dhënë vetë pëlqimin për dhënien e informacionit përkatës dhe Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për publikimin e këtij informacioni.

Nuk përbën sekret tregtar informacioni, që duhet të bëhet publik në bazë të ligjit, që lidhet me shkeljen e ligjit, apo që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare e parimeve të etikës tregtare. Përhapja e këtij informacioni vlerësohet e ligjshme, nëse nëpërmjet këtij akti synohet të mbrohet interesi publik.

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

**Shtojca 6**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik*]

**DEKLARATË MBI PERMBUSHJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik, që do të zhvillohet në datë _________________ nga Autoriteti Kontraktor________________ me objekt ____________ me fond limit __________.

Unë i nënshkruari _______________,me cilësinë e ________ të personit juridik _______________deklaroj se:

Përmbushim të gjitha specifikimet teknike, të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe e vërtetojmë këtë me çertifikata e dokumenta (nëse kërkohen nga autoriteti kontraktor), të dorëzuar bashkë me këtë deklaratë.

Data e dorëzimit të deklaratës ________________

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

**Shtojca 7**

[ *Shtojcë për t'u plotesuar nga Operatori Ekonomik*]

**<u>DEKLARATË</u>**
**<u>Mbi konfliktin e interesave</u>**

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë ________________ nga Autoriteti Kontraktor________________ me objekt ____________ me fond limit __________.

Konflikti i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejpërdrejtë ose të tërthortë që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij publike.

Në zbatim të nenit 21 pika 1 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve përcaktuar në Kreun III, Seksioni II, që iu ndalohet në mënyrë absolute të përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga lidhja e kontratave me një palë një institucion publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, zvkryeministri, ministrat, ose zvministrat, Deputetet, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët e Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë e në atë të Apelit, Avokati i Popullit, Anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Anëtarët e Enteve Rregullatore, (Këshilli i Mbikqyrjes i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zv/Guvernatorin; të konkurrencës, telekomunikacionit; energjisë; furnizimit me ujë; të sigurimeve; letrave me vlerë; mediave), Sekretarët e Përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar tjetër, në çdo institucion publik, që është të paktën i barazvlefshëm për nga pozicioni me drejtorët e përgjithshëm, titullarët e institucioneve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

  Për zyrtarët e nivelit të mesëm drejtues sipas nenit 31, dhe për zyrtarët e parashikuar në nenin 32 të kreut të III, seksioni 2 të këtj ligji, ndalimi sipas pikës 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave në fushën e territorit dhe të juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë është një institucion i varësisë.

Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij ligji janë **bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi, fëmijë në moshë madhorë, prindërit e zyrtarit të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.**

Unë i nënshkruari ____________________, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik _______________deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** te Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës ________________

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi**

**____________________________**

Vula

**Shtojca 8**

**[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik*]**

**DEKLARATË MBI PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME**

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesemarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë_______________ nga Autoriteti Kontraktor ___________ me objekt ___________________me fond limit __________.

Unë i nënshkruari __________________me cilesinë ___________të operatorit ekonomik ___________________ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik ______________________ është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat jo Fitimprurëse".

- Operatori ekonomik ____________________ nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara Nenin 45/1 të LPP.

- Personi/at në cilësinë e ***anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik,*** si më poshtë:

  _____________________
  _____________________
  _____________________etj.

  nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP[1].

- Operatori ekonomik ____________________ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

- Operatori ekonomik ____________________ nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

- Operatori ekonomik ____________________ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e**

**informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Data e dorëzimit të deklaratës _____________**
**Nënshkrimi i ofertuesit ______________**

**Vula ______________**

**Shtojca 8/1**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik*]

**DEKLARATË MBI GARANTIMIN E ZBATUESHMËRISË SË DISPOZITAVE LIGJORE NË**

**MARRËDHËNIET E PUNËS**

Deklaratë e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës në proçedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _______________ nga Autoriteti Kontraktor ___________ me objekt _______________me fond limit __________.

Unë i nënshkruari __________________me cilësinë e ___________të operatorit ekonomik __________________, **deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:**

- Operatori ekonomik ________________________garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik___________________lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik ________________nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

**Data e dorëzimit të deklaratës _____________**
**Përfaqësuesi i ofertuesit**
**Nënshkrimi**
**Vula**

**Shtojca 9**

[ *Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor*]

**1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat jo Fitimprurëse".
b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

**Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.**

**Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.**

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:**

**a.** Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
**b.** Prokura e posaçme.

**2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*
*b. Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar sipas Shtojcës 2/1;*
*c. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6;*
*d. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*
*dh. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojces 8/1;*
*e. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

**2.1 Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:**

Ky kriter plotësohet referuar kritereve te përgjithshme të pranimit/kualifikimit pika 1 e dokumentave standarte te tenderit te cilat mbeshteten në nenin 46, të Ligjit Nr. 9643, datë 20/11/2006, "Për prokurimin Publik", i ndryshuar dhe vërtetojnë se operatorët ekonomikë kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi ose, në rastet e bashkimit të shoqërive, vërtetojnë se i gëzojnë këto aftësi në kohën e lidhjes së kontratës.

**2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**a)** Kopje të çertifikuara të bilanceve të 2 (dy) viteve të fundit ushtrimore (2018, 2019) të paraqitura në autoritet përkatëse.

**b)** Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga Administrata Tatimore/Vërtetim të gjeneruar dhe vulosur me anë të një proçedure automatike nga një sistem elektronik për xhiron mesatare vjetore të realizuar gjatë dy viteve të fundit financiare (2018, 2019) nga data e zhvillimit te tenderit lëshuar nga autoriteti përkatës, vlera mesatare e së cilës duhet të ketë një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit limit përkatësisht 5.333.320 (pesë milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e njëzet) lekë pa tvsh.

**c)** Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2019 dhe 2020 sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" (i ndryshuar).

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB)

**2.3 Kapaciteti teknik:**

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e zhvillimit te tenderit, me një vlerë sa 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet ose 5.333.320 (pesë milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e njëzet) lekë pa tvsh.

a) Kur furnizimi i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e plotë dhe të suksesshëm të kësaj kontrate.

b) Kur furnizimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë furnizim duke paraqitur faturën përkatëse tatimore ku të jetë shënuar datat, shuma, sasia e mallrave të furnizuara, të nënshkruar nga të dyja palët.

2.3.2 <u>Oferta teknike:</u>

1. Skeda teknike të tekstilit të përdorur për prodhimin e artikujve, e lëshuar nga prodhuesi i tekstilit dhe e pajisur me logon, kontaktet (telefon, email, faqe interneti), adresën, emër mbiemër dhe firmën e përfaqësuesit ligjor me vulën e kompanisë prodhuese të tekstilit.
2. Dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare (raporte testimi) të materialeve përbërëse të produkteve, të lëshuara nga laboratorë të akredituar sipas standarteve kombëtare/ ndërkombëtare në fuqi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. (Copa e përdorur për artikullin mostër, lëndës së parë që shoqëron atë dhe ajo që i bashkëngjitet fletë -analizës duhet të jenë detyrimisht të njëjta).

Artikujt në mënyrë që të përputhen me kërkesat e përcaktuara nga standarti EN duhet të jenë të

modeluar dhe prodhuar për të përmbushur kërkesat thelbësore të shëndetit dhe sigurisë të përcaktuara me rregulloren EU nr 425/2016.
3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë si pjesë të ofertës teknike mostrat/ kampionet e artikujve që kërkohen të prokurohen, të përcaktuar në DST ne përputhje me specifikimet teknike, si më poshtë:

a) Operatorët ekonomik detyrimisht duhet të paraqesin nga një mostër fizike për objektet e uniformës (produkt të gatshëm) që do të prokurohen që përfshin të gjitha detajet, llojin e materialit dhe pjesëve përbërëse të tyre, punimin dhe përmasat e caktuara në specifikimet teknike.
b) Mostrat fizike të ndërtuara me lëndë të parë tekstil të jenë të shoqëruara me nga një pjesë 0,3-0,5 ml gjatësi lëndë të parë (tekstil sipas objekteve të uniformës) dhe sa gjerësia e vetë tekstilit në përputhje me specifikimet teknike të materialeve përbërëse të produktit. Të dyja anët e tekstilit të jenë të mbyllura në anë (format të rregullt) dhe të shoqëruara me raporte testimi (Flete analizë) origjinale të lëshuar nga laboratorët të akredituar sipas standarteve kombëtare/ ndërkombëtare në fuqi që kanë kryer analizën për karakteristikat (treguesit) fiziko- mekanike-kimike te tyre.
c) Mostrat fizike si këpucet etj të ndërtuar me lendë të parë lëkure të jenë shoqëruar nga një pjesë 0,3X0,3cm lëkure në përputhje me specifikimet teknike të materialeve përbërëse të produktit dhe të shoqëruara me raporte testimi (Flete analizë) origjinale të lëshuar nga laboratorët të akredituar sipas standarteve kombëtare/ ndërkombëtare në fuqi që kanë kryer analizën për karakteristikat (treguesit) fiziko- mekanike- kimike te tyre.
d) Të gjitha detajet e mostrave (produkt të gatshëm) që do të paraqiten nga operatorët ekonomike të jenë të qepura me penj të kuq me tegela të definuar si duhet pa fije të dala.
e) Mostrat e paraqitura duhet të kenë të trupëzuar një etiketë të qepur, e cila të përmbajë: mostër “emri i artikullit” datën e zhvillimit të tenderit, emrin e prodhuesit/ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik, të identifikueshme me numrin rendor përkatës në etiketë (sipas numrit rendor të tabelave *(psh:Nr.1- Këmishë me mëngë të gjata, referuar preventivit/ shtojcës 12).*
f) Mostrat do të paraqiten në datën dhe orën e hapjes së ofertave pranë Autoritetit Kontraktor Drejtoria e Prokurimeve, Bashkia Tiranë, me adrese: Bulevardi ”Deshmoret e Kombit”, Tiranë. Mungesa e mostrës dhe e lëndës së parë që shoqëron ato është kusht s’kualifikues.

*Mosparaqitja e mostrave sipas kërkesave të mësipërme përbën kusht s’kualifikimi për vazhdimin e procedurave.*

4. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i çertifikuar sipas standardeve ndërkombëtare ISO 9001:2015 (ose ekuivalente të vlefshme) të sistemit të menaxhimit të cilësisë dhe në rastin kur ai nuk është prodhues të paraqesë certifikatën përkatëse të prodhuesit që vërteton se sistemi i menaxhimit te cilësisë së prodhuesit të mallrave objekt prokurimi, është sipas ISO 9001: 2015 (e perkthyer dhe e noterizuar në shqip) e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

5. Ofertuesi duhet të paraqesë certifikatë OEKO-TEX për tekstilet të vlefshme.

6. Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij teknik specialist të fushës me eksperiencë pune minimale tre vjeçare në llojin e profesionit të kërkuar, në pozicionin e punës inxhinier Tekstil (të paktën një punonjës). Për këtë Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të diplomës, kopje të librezës së punës dhe listëpagesë të deklaruar në organet tatimore (Formulari E-SIG 025) për periudhën 6 (gjashtë) muajt e fundit duke marrë si referencë datën e hapjes së ofertave.

7. Operatori ekonomik duhet të deklarojë nëse është prodhues ose tregëtues i autorizuar nga prodhuesi për artikujt për këtë objekt prokurimi. Në rast se ofertuesi nuk është prodhues duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi i mallrave dhe të vërtetohet lidhja midis tyre. Autorizimi duhet të ketë të

përcaktuar adresën e saktë të firmës që e ka lëshuar këtë dokument, adresën e postës elektronike, emrin, funksionin e zyrtarit nënshkrues, vulën e shoqërisë (kjo e nevojshme per AK në rast verifikimi), të jetë i lëshuar për këtë objekt prokurimi dhe për llogari të Autoriteti Kontraktor Bashkia Tiranë.

8. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë se merr përsipër me anë të mjeteve të tij të bëjë furnizimin e mallit objekt prokurimi në adresën e autoritetit kontraktor me shpenzimet e tij.
Për kryerjen e transportit, duhet të disponojë të paktën 1 (një) mjet transporti tip furgon të pajisur me dokumentacion si më poshtë:

Në rastet kur mjeti është në pronësi: *Certifikatë pronësie; dokument që vërteton regjistrimin e mjetit- Leje Qarkullimi; siguracionin e vlefshëm të mjetit (policën e sigurimit); çertifikatën e vlefshme të kontrollit teknik (SGS); taksa vjetore.*

Në rastet kur mjeti është me qera: *Kontratë Qeraje noteriale për gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi; Certifikatë pronësie; dokument që vërteton regjistrimin e mjetit- Leje Qarkullimi; siguracionin e vlefshëm të mjetit (policën e sigurimit); çertifikatën e vlefshme të kontrollit teknik (SGS); taksa vjetore.*

*Për vërtetesinë e të dhënave të kërkuara e të deklaruara nga operatorë ekonomike, apo dhe të mostrave fizike që paraqiten (të shoqëruara me dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare (fletë-analizë) të lëshuara nga laboratorët përkatës, Autoriteti kontraktor kur vëren dyshime i lind e drejta të verifikojë ato. Mospajtueshmëria përbën kusht s'kualifikimi.*

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

**Shtojca 10**

## SPECIFIKIMET TEKNIKE

**Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi**

### Uniforma dhe veshje të tjera speciale për Policinë Bashkiake

### 1. KEMISHE ME MENGE TE GJATA

Keto specifikime teknike percaktojne kerkesat cilesore te prodhimit te kemishave te Policise Bashkiake, me menge te gjata, me pupline te tezgjahur, cilesi e pare.

Realizohen ne linje industriale, ne mbeshtetje te pamjes se jashtme te mostrave fizike (kemishe nr. 41/42 dhe dy jaka te gateshme) e prodhuar me materialet e poshteshenuara, te shoqeruar me min 0.3 ml gjatesi lende e pare (tekstil boje qielli) dhe sa vete gjeresia e tekstilit. Te dy anet e tekstilit te jene te mbyllura ne forme te rregullt.

Mostrat e sjella nga prodhuesi e te miratuar nga perdoruesi (porositesi), te depozituara sipas

percaktimeve do te sherbejne si baze per prodhim.

**Materialet qe do te perdoren per prodhimin e kemishave:**

- Pupline cilesi e pare, bojqielli, tekstil i tezgjahur, me perzjerje 33% pamb.dhe 67% poliest.(± 3%).
- Fortese mansheti per menget me kollaritje te plote.
- Prodhohen me jake te mbyllur.
- Numri i fillit: ne baze 75/1 -80/1; ne ind 75/1-80/1.
- Numrat e gjoksit 7, nga 44 - 56 .
- Dendesia ne 10 cm: ne baze 450 ± 10 ; ne ind 300 ± 10.
- Pesha: = 108 ± 3 gr.
- Thurje garniture.
- Qendrueshmeria (kg): 70 -6 ; ne ind 40 - 6.
- Penj qepje 100 % poliester me ngjyren e tekstilit ose ngjyre tjeter me ndryshim te pa perfillshem.
- Numrat e jakes: 36,37-38,39-40,41-42,43-44,45-46,47-48,49-50.
- Frazeline me ngjitje per forcimin e spalines, kapakeve te xhepave.
- Ne gjoks ka dy xhepa pllake me muzhik, me kapak me permasa 14x16 cm.

  - Kopsa te vogela me ngjyren e tekstilit ose te bardha te shndritshme me kater vrima. Kopsa te vogela plastike ngjyre argjendi per xhepat dhe spalinat.
  - Ne krahun e majte, poshte kokes se supit qepet shiriti hark me fushe bojeqielli, ku shkruhet me qendisje me penj te bardhe “POLICIA BASHKIAKE” dhe nen te qepet stema e bashkise.
  - Ne gjoksin e djathte, mbi qepjen e kapakut te xhepit, qepet bazament velkrofi 70x20 m/m per vendosjen e numurit personal.
  - Viera e qendrueshmerise se ngjyres te lendes se pare (pupline boje qielli) te jene te qendrueshme e shume te qendrueshme, nota 4-5 sipas S.SH.- 658/ 13- 88 .
  - Konsiderohen difekte te perhapura te pamjes se jashteme dhe nuk lejohen: papasterti me orgjine bimore, njolla te ndryshme, sperkatje me vajra ose bojra, nuanca te ngjyres, oksidime, palosje, rrudhosje, mungese fije ne baze e ind, trashim i fijeve, lekundje ne gjeresi etj..

- Mostrat e puplines qe shoqerojne kemishet te jene me gjatesi 600- 700m/m (S.SH.658-88).

## 2. KEMISHE ME MENGE TE SHKURTERA

Keto specifikime teknike percaktojne kerkesat cilesore te prodhimit te kemishave me menge te shkurter per Policine Bashkiake, me pupline te tezgjahur, cilesi e pare, me perzierje 33% pambuk dhe 67% poliester(± 3%).

Realizohen ne linje industriale ne mbeshtetje te pamjes se jashteme te mostres (nje kemishe me nr jake 41/42), te ndertuar me materialet e poshteshenuara, te shoqeruar me nje jake dhe nje pjese min 0.3 ml gjatesi lende te pare pelhure sintetike me gjeresine e vet tekstilit.

Mostra e sjelle nga prodhuesi e te miratuar nga perdoruesi (porositesi), te depozituar sipas percaktimeve, do te sherbeje si baze per prodhim.

**Materialet qe do te perdoren per prodhim:**

- Puplina eshte ne ngjyre dhe me cilesi te njejta me puplinen e kemisheve me menge te gjate, penjte per qepje etj..
- Jaka e mbyllur me kollaritje .
- Spalinave dhe kapakeve te xhepave u vendoset frazeline.
- Gjatesia e menges per prerjen e pare eshte 250 m/m, me rritje nga lO(dhjete) m/m per qdo prerje, gjeresia 230 m/m.
- Qepja te behet me penje 100% poliester ne ngjyren e kemishes me 25-30 shpime gjilpere ne 50 m/m gjatesi.
- Menget ne fund kthehen nga brenda dhe tegeli nga buza 23 mm.
- Menget ne fund kthehen nga brenda dhe tegeli nga buza 23 mm.
- Dy xhepa pllake ne gjoks, me permasa: gjeresi x lartesi= 140x160 m/m, me kapak(shih skicat).
- Kapaket e xhepave dhe spalinat mberthehen me kopsa ne ngjyre argjendi.

- Kapaket e xhepave, spalinat dhe menget (ne bashkim me trupin) te kene tegela nga jashte me 3 – 4 hapa ne 10 (dhjete) m/m dhe me largesi nga buza 5 mm.

- Ne krahun e majte anash, poshte kokes se supit, qepet shiriti hark ku shkruhet me qendisje, me penj te bardhe “POLICIA BASHKIAKE” shiriti ne forme harku me gjatesi: harku i siperm 105 m/m, harku i poshtem 80 m/m, gjeresia 25 m/m dhe fileto e kuqe ne te gjithe gjatesine e buzeve. Ky shirit qepet 15 m/m poshte kokes se supit, simetrik me qepjen e spalines. Poshte shiritit 33 m/m qepet Stema e Bashkise, simetrike me harkun e poshtem.

## <u>3. KEPUCE (1/2) ME LEKURE NATYRALE BOKS VICI</u>

Keto specifikime teknike percaktojne kerkesat cilesore te prodhimit te kepuceve gjysma.

Realizohen ne linje industrial ne mbeshtetje te pamjes se jashtme te mostres fizike nje pale kepuce nr. 41- 42, te ndertuara me materialet e poshteshenuara, te shoqeruar me nje pjese 30 x 20 cm lende e pare, boks vici dhe astar meshin viçi cilesi e pare.

Mostrat e sjella nga prodhuesi dhe te miratuara nga perdoruesi (porositesi), te depozituara sipas percaktimeve, do te sherbejne si baze per prodhim.

Mostra duhet te jete e qepur me penj te kuq, mosparaqitja perben kusht skualifikimi.

**Materialet qe do te perdoren per prodhimin e kepuceve :**

- Lekure me faqe natyrale, boks vici ngjyre e zeze. Lekuret te jene te shtrira mire, te buta, te mbushura, te ngjeshura e kompakte.
- Astar meshin vici, pa sharruar, me trashesi 0.9 + 1.2 mm per astar shtroje dhe pjesen e brendeshme e perparme(astar faqe). Meshina me prekje me dore te jete e bute, e ngjeshur,

e kompakte, e shtrire, lejohet te kete pak push. Meshina te kete ngjyre te njellojte ne te gjithe siperfaqen dhe te qendrueshme. Ne astar faqja e brendeshme e perparme etj.(pa astar shtroje) lejohet qe meshina te jete me trashesi 0.7 + 0.9 mm.

- Taban soleti (lekure natyrale), me trashesi 2 + 3 mm. Tabanit ne pjesen e thembres i vendoset nje kamarete (shirit peliku) te kanalizuara me vrature te permasave: gjatesia 80+85 mm gjeresia 8+10 mm dhe trashesi 1+1.2 mm.
- Penj sintetik mbi 9 kg, nr. 40/3 dhe 30/3 per qepjen e vesheve, prapshtina, filetat dhe tegelat etj.
- Gjeresia e pjeses se mbyllur te faqes se makines dy gjylperesh te kete distance 1.5+2 mm.
- Tegeli duhet te jete 1+1.5 mm large buzeve dhe te kete 3-4 hapa ne 10 mm ne lapete dhe ne rrumbullaksine e theksuar ku uniformiteti nuk ruhet. Ne mbylljen e syprines, behet perforcimi me tegela dopio.
- Bombe termoplastike ne pjesen e majes te kepuces.
- Forte termoplastike ose kartoni te presuar, i posaqem qe nuk thyhet, i Lyer me solucion kundra ujit ( qe nuk thith uje ).
- Sholle gome te presuar, nga poshte me lule e kanale, me thellesi 4±5 mm. Taka e kepuces bashke me kanalet e poshteme te jete me lartesi 22-f23 mm, ndersa bashke me fjapen do te jete me lartesi 28-L30 mm. Taka te jete unike, nje trup me shollen e gomes.
- Ngjites me nje komponent per ngjitjen e fjapes me tabanin dhe me dy komponente per ngjitjen e fjapes me shollen e gomes. Rezistenca e ngjitjes se fjapes me tabanin dhe e fjapes me shollen te jete shume e mire.
- Me kater vrima ne te dy anet, me syza, per kalimin e lidhesave .
- Lidhesat te jene te zeza, te rrumbullakta, prej fije teritali e poliestre deri 600 mm gjatesi.
- Maja e kepuces te jete kare (gjysem katrori), ne forme harku te lehte ne te dy kendet.
- Lartesia e qafes se kepuces (duke ju referuar nr. 41) e matur nga jashte mbi xhiron e gomes te jete 65 ± 1 mm,ndersa e matur nga brenda mbi astarin shtroje te jete 58+1 mm.
- Ne pjesen e siperme prapa qafes se kepuces, vendoset sfungjer me gjeresi 15 mm dhe gjatesi 250 + 275 mm ne varesi te numurit.

**KARAKTERISTIKAT FIZIKO-MEKANIKE E LEKURAVE NATYRALE (Boks vici) PER KEPUCE GJYSMA (1/2), (S.SH-1143-89)**

- Trashesia : 1.1-1.4mm
- Yndyra ne % : 4-7
- Rezistenca ndaj keputjes se faqes : 2.0
- Qendrueshmeria e plasjes se faqes 10 Mp (kg/mm$^2$) : 1.8
- Qendrueshmeria deri ne keputje ne % : 40-60
- Penetrimi i ujit ne jo me pak se : 40’ (dyzete minuta)

**SHOLLE GOME E FJAPE GOME TE PRESUAR**

- Fortesia ne grade shore **:** 75 ±3

## 4. KEPUCE ME QAFA, TRUPE, ME LEKURE NATYRALE

Keto specifikime teknike, percaktojne kerkesat cilesore te prodhimit te kepuceve me qafa, trupe per Policine Bashkiake.

Realizohen ne linje industriale, ne mbeshtetje te pamjes se jashteme te mostres fizike, nje pale kepuce nr. 41-42, te ndertuara me materialet e posheshenuara, te shoqeruar me nje pjese lende e pare 30 x 20 cm, vaqet cilesi e pare dhe astar meshin dhije cilesi e pare.

Mostrat e sjella nga prodhuesi dhe te miratuara nga perdoruesi (porositesi), te depozituara sipas percaktimeve, do te sherbejne si baze per prodhim.

Mostra duhet te jete e qepur me penj te kuq, mosparaqitja perben kusht skualifikimi.

**Materialet qe do te perdoren per prodhim :**

- Faqe natyrale (vaqete) cilesi e pare, kromato, tip “ U ”.
- Astar meshin dhije 0,9-rl,lm/m per te gjitha pjeset e brendeshme. Lejohet me trashesi 0, 7 4 0, 9 m/m ne faqet e brendeshme e te perparme .
- Taban soleti (lekure natyrale ).
- Kamarete qeliku e mbuluar me kartonfiber te presuar.
- Penj sintetik mbi 9 kg. nr. 40/3 - 30/3 per qepjen e syprines. - Mbyllja e syprines me tegela dopio ose 4 cope butona per pale.
- Bombe termoplastike per pjesen e majes.
- Fortese termoplastike ose karton i presuar i posagem per prapshtinen.
- Fjape gome te presuar me trashesi 2, 8 ~3.0 mm.
- Xhiro gome te presuar, trashesia 2, 8 43.0 mm.
- Sholle gome te presuar ( nga poshte me llokma te dhembezuara). Trashesia pa llokma:

7-r8 mm, me llokma: 17 -f 18 mm.

- Taka e kepuces me llokmen, lartesia 25 -f 26 mm, ndersa bashke me hapsiren qe shoqerohet me xhiron e gomes, lartesine e takes do te jete 32 ± 1 m/m.
- Penj sintetik fill 1 m/m me rezistence 38 kg per qepjen e fjapes me tabanin.
- Ngjites me nje komponent per ngjitjen e fjapes me tabanin.
- Ngjites me dy komponent per ngjitjen e fjapes me gomen (shollen).
- Me kater vrima me size ne fillim ne te dy anet e ne vazhdim te vrimave gjashte kapse ne forme gonxhe ose fisash per kalimin e lidhsave ne forme kordoni.
- Lartesia e qafes se kepuces 230 ± 2 m/m mbi xhiron e gomes.

- Ne mbyllje te lartesise midis kapses 8 dhe 9 deri tek kapsja e 10 (sa gjeresia e tyre ) nga 20 m/m larg buzeve (vize ose gonxhe ) vendoset sfungjer midis astarit dhe lekures dhe e qepur brenda jashte me penje sintetik.
- Semenca makine me gjatesi 8-r9 m/m per mberthim te faqes se kepuces me tabanin ne pjesen e prapme .

**KARAKTERISTIKAT FIZIKO-MEKANIKE E LEKUREVE NATYRALE (boks-vici) PER KEPUCE ME QAFA (SSH-2638-87) ( SSH 2896-87)**

- Trashesia : 1.9 - 2.5mm

- Yndyra ne % : 8-11

- Rezistenca ndaj keputjes se faqes : 2.0

- Qendrueshmeria e plasjes se faqes 10 Mpa (kg/mm$^2$) : 1.6

- Qendrueshmeria deri ne keputje ne % : -70

- Penetrimi i ujit ne jo me pak se : 240’ (4 ore)

**SHOLLE GOME E FJAPE GOME TE PRESUAR**

- Fortesia ne grade shore **: Sholla :** 85 ±3

**Fjapa :** 75 ±3

**5. KARAKTERISTIKAT FIZIKO-MEKANIKE-KIMIKE PER KOSTUM DOK-TRIKOTON**

Keto specifikime teknike percaktojne kerkesat cilesore te prodhimit te kostumit dok-terikoton te policise bashkiake.

Realizohen me tekstil te tezgjahur, ne linje industriale ne mbeshtetje te pamjes se jashtme te mostrave fizike (l xhakete, l kapele, l pale pantallona), numër gjoksi 54; gjatesi trupore 173-178 cm (prerja IV), kapele nr.56, te ndertuara me materialet e poshteshenuara, te shoqeruara me nga nje pjese lende e pare min 0.3 ml gjatesi dhe sa gjeresia e tekstilit.

Mostrat e sjella nga prodhuesi e te miratuar nga perdoruesi (porositesi), te depozituara sipas percaktimeve, do te sherbejne si baze per prodhim.

Mostra duhet te jete e qepur me penj te kuq, mosparaqitja perben kusht skualifikimi.

**Materialet qe do te perdoren per prodhimin e kostumeve:**

- Dok terikoton blu i erret, me fije kuadrate te vogla (antistatic) cilesi e pare, perzjerje 67% poliester me 33% pambuk(± 3%);

- Pesha per m$^2$ =260 ± 5 gr. - Thurje = sarzh 3/1. - Numri i fillit: Ne baze e ind = 35/1 ± 3 ; Dendesia ne 10 cm :

a) Ne baze 470 ± 6; b) Ne ind 210 ± 6 ;

- Qendrueshmeria kg : a) Ne baze = 153 - 6 ; b)Ne ind = 60 - 6 . - Frazeline (fortese). Shirit fosforeshent ne ngjyre argjendi per ne shpine te xhaketes me gjeresi 30 m/m.. Astar xhepi tekstil, 100% viskoz dhe qemer i pergatitur per pantallonat. Ekstrafor, zinxhir konfeksioni 22 - 24 cm me dhembe plastik per pantallonat; Penj qepje blu 80/2 , qepje industriale 100% poliester . -Per^nat me tel suste. Viera e qendrueshmerise se ngjyres te lendes se pare te jete nota 4 – 5

( SSH 658 - 88 ).

**- Xhaketa** me jake sport, me spaleta, me kater xhepa pllake me kapak ne gjoks dhe poshte gjoksit te cilet mbyllen me nga dy velkro, mbyllja perpara me zinxhire dhe me ballome e cila te jete jo me shume se 6 cm e gjere. Ajo fsheh zinxhirin dhe mbyllet me tre butona me diameter 1.5 cm. Me llastike te gjere ne te dyja anet e belit. Mansheti i menges te jete me gjeresi 4 cm dhe mberthehet me velkrof. Mansheti te kete nje carje te lehte ne polse me thellsi 10 cm. Ne krahun e majte, poshte kokes se supit, qepen shenjat dalluese. Mbi xhepin e djathte, ne gjoks qepet velkrof per numurin personal.

**- Pantallonat** te kene dy xhepa para te brendshem; dy xhepa anesor tip zarf 18 cm dhe lartesi 20cm me kapak 6cm dhe gjeresi 18cm; dy xhepa prapa pllake 14 cm dhe lartesi 15cm me kapak 16cm dhe lartesi 6cm me mbyllje me dy velkrofe ne skaje; Mbyllja perpara te jete me sallki me zinxhire dhe me qemer 4cm te gjere i cili pershkruhet nga pese ylyqe.

**- Kapela** sportive, me strehe te gjate plastike e veshur me dokun e vet, me perforcim ne kupe, me rrip prapa per rregullimin e gjeresise, ne balle shkruar me qendisje me penj te bardhe ne forme harku “POLICIA BASHKIAKE” dhe poshte qepet sterma e Bashkise.

**Pantallonat prodhohen ne gjatesite dhe prerjet e poshteshenuara:**

**Gjatesia e trupit (ne cm) Gjat. e pantallonit (cm) Prerja**

155-160 93 pare

161-166 97 dyte

167-172 100 trete

173-178 103 katert

179-184 106 peste

185-190 110 gjashte

## 6. KOSTUM TERITAL BLU

Keto specifikime teknike percaktojne kerkesat cilesore te prodhimit te kostumeve blu te Policise Bashkiake.

Realizohen me tekstil te tezgjahur ne linje industriale, ne mbeshtetje te pamjes se jashteme te mostrave fizike (l xhakete, 1 kapele, l pale pantallona), numer gjoksi 54; gjatesi trupore 173 - 178 cm (prerja IV), kapele nr.56, te ndertuara me materialet e poshteshenuara, te shoqeruara me nga nje pjese min 0.3 ml gjatesi lende e pare (stof blu) dhe sa gjeresia e tekstilit.

Mostrat e sjella nga prodhuesi e te miratuar nga perdoruesi (porositesi), te depozituara sipas percaktimeve do te sherbejne si baze per prodhim.

Mostra duhet te jete e qepur me penj te kuq, mosparaqitja perben kusht skualifikimi.

**Materialet qe do te perdoren per prodhimin e kostumeve:**

- Stof ngjyre blu i erret, cilesi e pare me perzjerje 45 % lesh dhe 55%poliester ( ±3% );
- Numri i fillit: a) Ne baze = 40/2, 42/2; b) Ne ind = 40/2, 42/2;
- Dendesia ne 10 cm: a)Nebaze =310 ±10; b) Ne ind = 260 ± 10;

- Qendrueshmeria kg: a) Ne baze = 90-6; b) Ne ind = 80-6;

- Astar mendafshi importi(blu e erret ose e zeze) 100% poliester.

- Merle ( material ngjites special dhe i pershtatshem per pjesen e gjoksit ),100% poliester. Frazeline (material ngjites

per xhaketen dhe pantallonat).

- Astar xhepi, tekstil 100% viskoz. - Vata (jo pambuku) te posapme per kostum burri.

- Penj qepje blu 80/2, qepje industriale 100% poliester. - Thurje = sarzh.

- Kopsa te vogela e te medha, ngjyre argjendi. Fusha e kopses te jete e paster, pa relieve e konfiguracione te

ndryshme brenda.

- Kanavace importi, 100% lesh.

- Stof leshi me ngjyre te pershtateshme per pjesen e nenteshme te jakes se xhaketes.

- Viera e qendrueshmerise se ngjyrave nota 4-5.

- Pesha per $m^2$ = 290 ± 10 gr.

**- Xhaketa :** Monopet, me kater kopsa te medha para, me prerje hark nga shpatulla deri ne fund, me garje prapa. Me dy xhepa pllake poshte (180 x 210 mm ) me kapak dhe larte ( 140 x 160 mm ). Xhepat kane muzhike vertikal. Mbi xhepin e djathte qepet velkrof per numurin personal dhe ne krahun e majte, poshte kokes se supit qepet shiriti hark ku shkruhet me qendisje me penj te bardhe ” POLICIA BASHKIAKE ” dhe nen te sterna e Bashkise. Spaletat me permasa: 50 x 130 mm, me fileto te kuqe anash, mberthehen me kopse metalike ngjyre argjendi. Dy xhepa te brendshem qe mberthehen me kopse ebaniti ngjyre e zeze.

**- Pantallonat :** Kane dy xhepa anesor me prerje diagonale dhe nje xhep prapa ( 120 x 150 m/m ), pa kapak, mberthehet me kopse ebaniti. Kane nga dy pensa ne te dy anet. Zinxhir konfeksioni per mberthimin e pantallonave, me dhembe plastik.

Kapse metalike mashkull - femer per mbylljen e pantallonave dhe bishtok. Qemer i pergatitur per pantallonat. Shtate vega per kalimin e rripit 50 mm te gjere.

**TERITALI BLU (KAPELE)**

- Modeli-tip oficeri.

- Ka forme vezake.

- Materiali dhe ngjyra si e kostumit.

- Prodhohet ne dhjete numra (53 -f 62). Numri perfaqeson perimetrin e kokes. Strehe plastike (te mos deformohet nga ndryshimi i temperatures se ajrit), me shkelqim nga siper, me gjeresi ne qender 50 mm, ne ngjyre te zeze, me astar.Nga brenda kapelja ka astar mendafshi, dhe rreth tepelekut ( nga brenda ) ka te qepur nje shirit lekure me gjeresi 5 cm. Per te ruajtur formen, nga brenda vendoset nje flete geliku 5 mm e gjere me fortesi deri 60 mangan. Mbi strehe vendoset nje shirit plastik i zi (per inspektoret ngjyre argjendi) me shkelqim, me gjeresi 15 m/m dhe mberthehet anash me dy kopsa te vogela metalike ne ngjyre argjendi. Ne balle vendoset sterna e Bashkise me permasa: 50 m/m gjatesi e 34 m/m gjeresi.

**Legjenda:**

A - lartesia e rrethit te kapeles sipas perimetrit te kokes.

**B** - gjeresia e urave perpara.

C - gjeresia e urave prapa ( **shenim:** urat perpara dhe prapa jane te perforcuara me fortese te kollaritur).

**D** - gjatesia e tepelekut te kapeles.

E - gjeresia e tepelekut te kapeles.

**F** - permasat e rrethit plastik ne tepelek.

**7. KRAVATA**

Keto specifikime teknike percaktojne kerkesat cilesore te prodhimit te kravatave.

Realizohen ne linje industriale ne mbeshtetje te pamjes se jashteme te mostrave fizike (nje kravate) te ndertuar me materialet e poshteshenuara, te shoqeruar me nje pjese min 0.3 ml gjatesi lende te pare pelhure sintetike dhe sa gjeresia e tekstilit.

Mostra e sjelle nga prodhuesi e te miratuar nga perdoruesi (porositesi), te depozituar sipas percaktimeve, do te sherbeje si baze per prodhim.

**Materialet qe do te perdoren:**

- Materiali cilesi e pare, pelhure sintetike, 100 % poliester.

- Ngjyra blu e erret.

- Gjatesia 500 ± 20 mm ;

- Gjeresia 45±5 m/m ne fillim (koka) e 80±5 m/m ne fund.

- Me astar mendafshi, importi,(blu i erret ose i zi),100% poliester. Frazeline per fortese nga brenda,

e lidhur ne forme koke dhe ne fund te jete ne forme trekendeshi dybrinjeshem.

- Me llastik te gjere 15 m/m qe kalon dhe fiksohet brenda kokes, dhe ne te dy anet e llastikut qepet velkrof per t'u mberthyer

ne qafe me gjatesi 40 deri 50 m/m.

- Pesha e pelhures sintetike 190 ± 5 gr/m$^2$.

**8. PANTALLONA TERITALI VERE**

Keto specifikime percaktojne kerkesat cilesore per prodhimin e pantallonave te veres te Policise Bashkiake me tekstil te tezgjahur, ngjyre blu i erret, cilesi e pare.

Realizohen ne linje industriale, ne mbeshtetje te pamjes se jashtme te mostres fizike (nje pale pantallona vere), numër gjoksi 54, 173 -178 cm, prerja e katert, te ndertuara me materialet e poshteshenuara, te shoqeruara me nje pjese lende e pare me gjatesi min 0.3 ml (tekstil blu i erret) dhe gjeresi sa vete tekstili.

Mostra e sjelle nga prodhuesi dhe te miratuar nga perdoruesi (porositesi), te depozituara sipas

kerkesave do te sherbeje si baze per prodhimin e pantallonave.

Konsiderohen difekte te perhapura te pamjes se jashteme dhe nuk lejohen papasterti me orgjine bimore, njolla te ndryshme, nuanca te ndryshme te ngjyres, oksidime, rrudhosje, mungese fije ne baze e ind, trashim filli, lekundje ne gjeresi etj (S.SH. 1038-88).

Ngjyra e mostres do ti nenshtrohet proves si ndaj (ferkimit te thate, te njome, ne larje solucioni, sapune, djerse, etj.) dhe nuk duhet te ndryshoje nga ajo e depozituara. Copa e bardhe qe do te shoqeroje mostren pothuajse nuk ndotet, mbetet pa ndotur, (S.SH. 658-88).

**Materialet qe do te perdoren per prodhimin e pantallonave te veres:**

- Stof blu i erret, cilesi e pare, i tezgjahur me perzjerje 35%viskoz dhe 65% poliester (±3%).
- Pesha per $m^2$: 210 ±5gr.
- Thurje = sarzh 2/1.
- Frazeline (material ngjites).
- Numuri i fillit: ne baze = 45/2 ±3; ne ind =52/1 ±3.
- Dendesia per 10 cm: ne baze =340 ±6 ; ne ind =265 ±6.
- Qendrueshmeria (kg): ne baze =153 - 6; ne ind = 70-6.
- Viera e qendrueshmerise se ngjyrave, nota 4 - 5 .
- Astar xhepi dhe qemeri, tekstil 100% viskoz.
- Penj qepje blu 80/2, 100% poliester ; qepje industriale.
- Zinxhir plastik konfeksioni 22-^24cm, kapse metalike (femer-mashkull), bishtok per mberthimin e

pantallonave.

- Perpara ka kater pensa (dy ne pdo ane) me thellesi 12 deri 15 m/m.
- Me dy xhepa anesor me prerje diagonale, nje xhep prapa -djathtas me permasa 120x150 m/m, mberthimi me kopse ebaniti

te zeze me kater vrima.

- Qemer i pergatitur per pantallonat. Shtate vega me gjeresi 50 m/m per kalimin e rripit te pantallonave.

**9. <u>PULOVRA</u>**

Keto specifikime teknike percaktojne kerkesat cilesore te prodhimit te pulovres se Policise Bashkiake.

Realizohet ne linje industriale ne mbeshtetje te pamjes e jashtme te mostres fizike (nje pulover nr. gjoksi 54/4, gjatesi trupore 173-178), te ndertuar me materialet e poshteshenuara.

Mostra e sjelle nga prodhuesi e te vlersuar nga perdoruesi (porositesi), te depozituar sipas percaktimeve, do te sherbeje si baze per prodhim.

**Materialet qe do te perdoren per prodhimin e pulovres :**

- Fill, cilesi e pare, me perzjerje 50 % akrilik + 50% lesh .
- Pesha = 600 ± 10 gr.
- Ngjyre blu e erret.- Punim i thjeshte.- Numuri i fillit 40/2 - 42/2.

- Dok terikoton blu me perzjerje pambuk e poliester per perforcimet e supeve e te brylave.

- Frazeline (fortese) per perforcimin e spaletes. - Ne gjoksin e djathte vendoset velkrof per bazamentin e numurit personal me permasat 75 x 20 m/m..
- Vlerat e qendrueshmerise se ngjyrave te lendes se pare (fill blu), te jene te qendrueshme e shume te qendrueshme (nota 4 - 5 ). Ngjyra e mostres qe do t'i neneshtrohet proves ne qendrueshmeri te ndryshme(si ndaj ferkimit te thate,te njome,ne larje solucioni,sapun e
- djerse,etj.) nuk duhet te ndryshoje nga ajo e depozituar. Copa e bardhe qe do te shoqeroje mostren ne prove nuk duhet te ndotet,(S.SH.-658 - 88 ).
- Jaka ne forme v-je, llastiku me gjeresi 30 m/m. - Mbyllja e mengeve dhe e fundit te trupit me llastik me gjeresi 50 m/m.
- Ne krahun e majte, 15m / m poshte kokes se supit qepet shiriti ne forme harku ku shkruhet me qendisje me penj te bardhe"POLICIA BASHKIAKE" dhe poshte tij sterna e bashkise e vendosur mbi nje katerkenesh doku vertical qe ka nje xhep.
- Spaletat, dok i plastifikuar me gjeresi 45 m/m dhe gjatesi sipas numurave, qe mberthehen me kopsa te vogela plastike, ne ngjyre argjendi.
- Ne lenden e pare (fill blu) cilesia e pare qe do te perdoret per prodhimin e pulovrave te Policise Bashkiake, konsiderohen difekte te pamjes se jashteme dhe nuk lejohen: papasterti me orgjine bimore, njolla te ndryshme, sperkatje me vajra ose bojra, nuanca te ngjyres, oksidime, rrudhosje, mungese fije ne baze e ind apo trashim i tyre, luhatje ne gjeresi etj,

S.SH.1038 - 88).

## 10. RRIP LEKURE, TELATINE, I ZI PER PANTOLLONA

Keto specifikime teknike, percaktojne kerkesat cilesore te prodhimit te rripit te pantallonave per Policine Bashkiake, me lekure telatine, cilesi e pare, me regjie gjysem kromi.

Realizohet ne linje industriale, ne mbeshtetje te pamjes se jashtme te mostres fizike (1 rrip i kompletuar) dhe nje pjese lende e pare 20 x 30 cm.

Mostra e sjelle nga prodhuesi dhe e miratuar nga perdoruesi (porositesi), te dpozituar sipas percaktimeve, do te sherbeje si baze per prodhim.

**Materialet qe do te perdoren per prodhimin e rripit:**

- Lekure natyrale (telatine) me regjie gjysem kromi, ngjyre e zeze.
- Trashesia e lekures 3.5 ±0.1 mm.
- Gjatesia e rripit 1200 - 1350 (±20m/m).
- Gjeresia e rripit 42±1.0 m/m .
- Siperfaqja e jashteme te kete uniformitet ne ngjyre dhe s'duhet te kete shenja te ndryshme qe e demtojne .

- Tokez metalike sipas modelit dhe permasave me material bronx i kromuar, me derdhje, ne siperfaqe te kete uniformitet, te mos kete gropezime e valezime, me kromim rezistent.
- Rapide te vogela metalike te kromuara.
- Rripi ne pjesen e perparme ka 7 (shtate) vrima me largesi 40 m/m nga njera-tjetra . Ka vegen qe realizohet me ngjitje rezistente me gjeresine e skajimit te jete 10 mm dhe pjesa e perfundimit te skajimit te jete 2 mm.
- Vega me gjeresi 15 mm e gjatesi 50 mm.
- Lekura (telatina) te jete plotesisht ne te gjithe siperfaqen e prerjes se terthorte dhe te kete perkulshmeri.
- Lekura (telatina) te jete e vajosur, pa plasaritje dhe te kete apreturim te mire.
- Lekura (telatina) te jete e ngjeshur dhe kompakte, te kete trashesi e gjeresi te barabarte ne te gjithe siperfaqen.
- Gjate ferkimit ne te thate e ne te njome, pelhura e bardhe e pambukut te mos ndotet nga boja qe jan ngjyrosur lekuret.

**KARAKTERISTIKAT FIZIKO - MEKANIKO - KIMIKE te lekures.**

**(S.SH.: 1145-89 )**

- Yndyra ne % : 8-1-15
- Rezistenca ndaj plasjes, kg/m$^2$ ne jo me pak se 10 Mpa : 2,0
- Rezistenca ndaj keputjes, kg/m$^2$ jo me pak se 10 Mpa : 2,5
- Koefiqienti i regjies: mire, shume mire, e plote, nuk tkurret.
- Zgjatimi deri ne keputje etj. Sipas S.SH..
- Prova e regjies : Pozitive
- Prova e mosregjies : Negative

## 11. XHUPI OPERACIONAL

Realizohet ne linje industriale, ne mbeshtetje te pamjes se jashteme te mostres fizike (1 xhup, numër gjoksi 52, gjatesi trupore 170-172 cm, prerja III), te ndertuar me materialet e poshteshenuara, te shoqeruara me nga nje pjese min 0,3 ml gjatesi lende e pare (tekstil impermeable i gomuar) dhe sa gjeresia e tekstilit. Te dy anet e tekstilit te jene te mbyllura ne ane (format te rregullt).

Mostrat e sjella nga prodhuesi e te vleresuara nga perdoruesi (porositesi), te depozituara sipas percaktimeve, do te sherbejne si baze per prodhim.

**Materialet qe do te perdoren per prodhimin e Xhupit (xhakaventos):**

- Material sintetik, 100% poliamid, kundra ujit, cilesi e pare, = 165 gr / m$^2$.
- Ngjyra blu e erret. - Thurje: Sarzh.
- Poshte astarit vendoset vatine = 120 ± 5 gr / m$^2$.
- Astar mendafshi importi ( blu i erret ose i zi), 100 % poliester, qepur ne forme rombi.

- Pesha e astarit per $m^2$ = 125 ± 5 gr.

- Numuri i fijeve si ne baze e ind ( per 10 cm ) do te jete 340 ± 10 fije .

- Qendrueshmeria ( kg ) ne baze = 95 ±5; ndersa ne ind = 90 ± 5.

- Viera e qendrueshmerise se ngjyrave, nota 4 - 5 .

- Nje xhep ne gjoksin e majte, i brendshem, me kapak te madh (shih skicen ) nga jashte qe mberthehet me Zinxhir konfeksioni plastik, nje xhep i brendshem ne anen e djathte qe mberthehet me kopse ebaniti dhe dy xhepa perpara - poshte me prerje diagonale.

- Mberthimi para i xhupit, me zinxhir konfeksioni me dhembe plastike dhe 3 percina ( me suste ).

- Qepje industriale, me penj blu 80/2; 100% poliester.

- Menget, tek dora kane bishtok dhe mberthehen me pergine, po keshtu mberthehen dhe spaletat.

- Jaka me stof ngjyre e zeze.

- Me kapug feshfeshe qe mblidhet prapa jakes.

- Fashe fosforeshente, ngjyre argjendi me gjeresi 30 m/m ne shpine dhe ne gjoksin e djathte.

- Prodhohet ne permasat: S; M; L; XL; XXL; XXXL .

- Gjatesia per madhesine XL = 70 cm.

- Ne krahun e majte anash, poshte kokes se supit, qepet shiriti hark ku shkruhet me qendisje me penj te bardhe " POLICIA BASHKIAKE " dhe nen te qepet Stema e Bashkise. Fusha e harkut dhe e stemes eshte ne ngjyre blu te hapur dhe anash me nje komize (imitim thurje) me qendisje me penj te kuq.

- Ne anen e djathte te gjoksit mbi fashe qepet bazament velkrofi per numrin personal.

**12. RRIP SHERBIMI – SINTETIK, TRUPE (MULTIFUNKSIONAL)**

- Këto specifikime teknike, përcaktojnë kërkesat cilësore të prodhimit të Rripit të shërbimit, sintetik për Policinë Bashkiake.
- Realizohet në linjë industriale, në mbështetje të pamjes së jashtme të mostrës fizike, një rrip shërbimi, sintetik, trupe.
- Ka mekanizëm të veçantë për rregullim të lehtë të gjatësisë edhe pse ekzistojnë madhësi të vecanta të rripit nga M deri te 2XL.
- Këto rripa janë specifikë për punonjësit e policisë, sepse në to mund të vihet këllëf për pistoletë, rezerva muncionesh, shkop, pranga, radio dhe çdo gjë që ju duhet.
- Ka ngjyrë të zezë kështu që përshtatet lehtë me uniformën ose pajisjen që ka veshur polici.
- Mostra e ndërtuar me materialet e poshtëshënuara e sjellë nga prodhuesi dhe e miratuar nga përdoruesi (porositësi), e depozituar sipas përcaktimeve, do të shërbejë si bazë për prodhim.

**Materialet që do të përdoren:**

- Materiali tekstil – sintetik, cilësisë së parë, me thurje të dendur ( nga tërheqja nuk zgjatohet).
- Astar velkrofi në gjysmën e gjatësisë fundore.
- Ngjyra : I zi.
- Gjatësia e përgjithëshme: 1350 ( ± 10 m / m ).

- Gjerësia : 55 ÷ 60 m/m.
- Tokëza për mbërthim : femër – mashkull ( metalike e kromuar ose plastike ) në ngjyrë të zezë.
- Vega : dy copë të futura në rrip, me gjerësi 15 m/m, me material metalik i kromuar ose sintetik të thurur.

**Ripi të jetë i kompletuar me aksesorët:**

- Këllëf për mbajtjen e prangave (hekurave lidhës ).
- Unazë për mbajtjen e shkopit të gomës.
- Mbajtese e radios.

**TABELA E PËRMASAVE RRIPIT SNTETIK (Multifuksional )**

| PRERJET E RIPIT | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | 0 | I | II | III |
| Nga minimumi | 70 | 80 | 100 | 110 |
| Nga maksimumi | 95 | 105 | 125 | 135 |

**13. SPALETA (E HEQSHME NE FORME KELLEFI)**

Keto specifikime teknike, percaktojne kerkesat cilesore te prodhimit te spaletave te heqshme per Policine Bashkiake, te realizuara ne linje industriale, ne mbeshtetje te mostres fizike, nje pale spaleta.

**Materialet qe do te perdoren :**

- Dok i cilesise se pare, i plastifikuar;

- Pesha : 120 ± 5 gr / m$^2$;

- Ngjyra blu e erret;

- Permasat: gjatesia ne mes=95m/m; gjeresia ne te dy daljet eshte perkatesisht: 50m/m dhe 58m/m.

- Gjithe konturet e spaletes jane me nje fileto plastike te kuqe me gjeresi 3 m / m.

**14. XHUP SINTETIK (XHAKAVENTO) - KUNDRA SHIUT**

Keto specifikime teknike percaktojne kerkesat cilesore te prodhimit te Xhupit sintetik te policise bashkiake.

Realizohet ne linje industriale, ne mbeshtetje te pamjes se jashteme te mostres fizike (1 xhup, numër gjoksi 52, gjatesi trupore 170 ± 172 cm, prerja III), te ndertuar me materialet e poshteshenuara, te shoqeruara me nga nje pjese min 0,3 ml gjatesi lende e pare (tekstil impermeable i gomuar) dhe sa gjeresia e tekstilit. Te dy anet e tekstilit te jene te mbyllura ne ane (format te rregullt).

Mostrat e sjella nga prodhuesi e te vleresuara nga perdoruesi (porositesi), te depozituara sipas percaktimeve, do te sherbejne si baze per prodhim.

**Materialet qe do te perdoren per prodhimin e Xhupit (xhakaventos):**

- Material sintetik, 100% poliamid, i papershkueshem nga uji, cilesi e pare.
- Pesha e materialit poliamid = 165 gr / m$^2$.

- Dy shtresa gomimi e dy shtresa akriliku. - Thurje garniture.
- Poshte astarit vendoset vatine = 120 ± 5 gr / $m^2$.
- Astar mendafshi importi ( blu i erret ose i zi), 100 % poliester, qepur ne forme rombi.
- Pesha e astarit per $m^2$ = 125 ± 5 gr.
- Numuri i fijeve si ne baze e ind ( per 10 cm ) do te jete 340 ± 10 fije .
- Qendrueshmeria ( kg ) ne baze = 95 ±5; ndersa ne ind = 90 ± 5.
- Viera e qendrueshmerise se ngjyrave, nota 4 - 5 .
- Nje xhep ne gjoksin e majte, i brendshem, me kapak nga jashte qe mberthehet me pergine, nje xhep i brendshem ne anen e djathte qe mberthehet me kopse ebaniti dhe dy xhepa perpara - poshte me prerje diagonale.
- Mberthimi para i xhupit, me zinxhir konfeksioni me dhembe plastike dhe 3 pergina ( me suste).
- Qepje industriale, me penj blu 80/2; 100% poliester.
- Menget, tek dora kane llastik, por dhe rrip qe mberthehet me pergine, po keshtu mberthehen dhe spaletat.
- Ngjyra blu e erret. Jaka me stof ngjyre e zeze. Me kapug feshfeshe qe mblidhet prapa jakes.
- Fashe fosforeshente, ngjyre argjendi me gjeresi 30 m/m ne shpine, gjoksin e djathte dhe 20 m/m tek rripi i mengeve.
- Prodhohet ne permasat: S; M; L; XL; XXL; XXXL .
- Gjatesia per madhesine XL = 86 cm.
- Ne krahun e majte anash, poshte kokes se supit, qepet shiriti hark ku shkruhet me qendisje me penj te bardhe “ POLICIA BASHKIAKE ” dhe nen te qepet Sterna e Bashkise. Fusha e harkut dhe e stemes eshte ne ngjyre blu te hapur dhe anash me nje komize (imitim thurje ) me qendisje me penj te kuq.

- Ne gjoksin e djathte mbi fashe qepet bazament velkrofi per numrin personal.

**15. PELERINA SHIU**

- Këto specifikime teknike përcaktojnë kërkesat cilësore për prodhimin e mushamasë së shiut, për Policinë Bashkiake.
- Realizohet në linjë industrial, në mbështetje të mostrës fizike (një mushama shiu), numri 52, masa trupore 170 – 172 cm, prerja II), të ndërtuar me materialet e poshtëshënuara, të shoqëruara me nga një pjesë min 0, 3 ml gjatësi lëndë e parë( tekstil impermeabël i gomuar ) dhe gjerësi sa gjerësia e tekstilit.
- Mostrat e sjella nga prodhuesi e të pranuara nga përdoruesi (porositësi), të depozituara sipas përcaktimeve, do të shërbejnë si bazë për prodhim.
- Mostra duhet të jetë e qepur me penj të kuq, mosparaqitja përbën kusht për skualifikim.
- Mostrat duhet të kenë vulë dhe etiketë orgjinale të fabrikës të trupëzuara në mostër.

- Mostra duhet të shoqërohet me fletë analizë laboratorike të treguesve fiziko – mekaniko – kimik të lëndës së parë tekstil impermeabël, të përdorur nga prodhuesi, të kryera nga laboratorë të autorizuar shqiptarë të fushës.

**Materialet që do të përdoren për prodhimin e mushamasë së shiut:**

- Materiali tekstil impermeabël i gomuar, tezgjahu, 100 % ëaterproof ( kundra ujit ) me të dhënat e mëposhtëme:
- Ngjyra: blu e erët ;
- Përbërja: 100 % poliamid;
- Thurja: garniturë 1+1;
- Masa : 125 ± 8 gr / m² ;
- Filli qepës: 100 % poliestër, në tonalitet me produktin dhe hollësia = 120;
- Dëndësia e fijeve në bazë e ind, për çdo 10 cm : 340 ± 10 fije;
- Qëndrueshmëria, në kg , në bazë e ind : 95± 5 kg;
- Numuri metrik: në bazë = 48/1 ± 2; në ind = 52/1 ± 2;
- Trashësia e tekstilit: 0.2 ÷ 0.3 m/m;
- Qëndrueshmëria në fërkim : Mbi 3000 ( tre mijë ) cikle;
- Qëndrueshmëria e ngjyrës : Nota 4 ÷ 5.
    - Ngjyra e mostrës i nënështrohet provës në qëndrueshmëri ndaj fërkimit në të thatë e të njomë, në larje solucioni dhe djerse, ngjyra nuk duhet të ndryshojë.

**Të përgjithshme**

- Mushamaja e shiut është e konfeksionuar në shtatë prerje (XS; S; M; L; XL; XXL; XXXL).
- Një velkrof me modelimin e stemës së Policisë Bashkiake në krahun e majtë, 20 m/m poshtë kokës së supit dhe një velkrof në gjoksin e djathtë me përmasa 70 x 20 m/m për numrin personal.

**Përshkrimi**

Mushamaja e shiut është e përbërë nga këto elemente :

a. Pjesa e përparme, me prerje në linjën qëndrore, me dy pjesë;
b. Pjesa e prapme (shpina);
c. Jaka;
d. Dy mëngë të gjata;
e. Kapuç i çmontueshëm (heqshëm).

**1. PERPARA**

Dy pjesët përpara janë prej materiali poliamid të padepërtueshëm ndaj ujit, me prejre përgjatë linjës qendrore. Dy pjesët bashkohen me anë të 5 preçinave me sustë, të kromuara.

- **Pjesa e majtë e veshur**

Paraqet një bordurë të brendëshme (palosje) me formë drejtëkëndore përgjatë pjesës qëndrore në të

gjithë gjatësinë e saj. Bordura e brendëshme është realizuar me dy shtresa tekstili me gjerësi rreth 5 cm, realizuar me anë të tegelit qepës një gjilpërësh. Përgjatë aksit qëndror të saj në distancë rreth 2 cm nga ana e jashtëme janë aplikuar pesë preçina “ femër ”, rreth 18 cm nga njëra –tjetra ( vlerë e ndryshueshme në bazë të prerjes ). Bordura e brendëshme e quajtur ndryshe dhe palë është e përshkuar në drejtimet e lira me anë të tegelit qepës një gjilpërësh rreth 5 mm dhe bashkohet me jakën dhe nën jakën në pjesën e sipërme me anë të tegelit qepës një gjilpërësh. Po në të majtë të veshur, mbi bordurën e brendëshme është montuar një bordurë e sipërme (palosje) e aplikuar përgjatë gjithë gjatësisë së mushamasë me gjerësi totale rreth 6 cm. Bordura e sipërme është realizuar me tekstil dopio të padepërtueshëm nga uji, me gjerësi rreth 6 cm. Është e përbërë nga copë tekstili dopio e papërshkueshme nga uji, me gjerësi rreth 5 cm.

Pesë preçina me sustë në distancë rreth 2 cm nga ana e jashtëme dhe në distancë rreth 18 cm nga njëra –tjetra. Kokat e preçinave janë montuar në pjesën e poshtëme të bordurës së jashtëme dhe janë të padukshme pasi janë montuar ndërmjet dy shtresave; ndërsa preçinat “femër” janë montuar në brendësi të tekstilit poliamid.

- **Pjesa e djathtë e veshur.**

Ashtu si pjesa e majtë dhe pjesa e djathtë e veshur është realizuar me anë të një bordure teke të realizuar me tekstil të njëjtë. Në bordurën e djathtë, në distancë rreth 2 cm nga ana e jashtëme dhe rreth 18 cm nga njëra – tjetra, përgjatë aksit qëndror janë montuar pesë preçina të përbëra nga dy pjesë “ mashkull ”, njëra e dukshme dhe tjetra e montuar në palosjen e brendëshme. Bordura është e përshkuar në drejtimet e lira me anë të tegelit qepës një gjilpërësh rreth 5 mm dhe bashkohet me jakën dhe nënjakën në pjesën e sipërme.

Qëllimi i kësaj mbyllje të veçantë qëndron në faktin se duke realizuar një mbyllje të tillë evitohet depërtueshmëria e ujit nga brenda duke bërë të korrespondojnë precinat “femër” të pjesës së majtë të veshur me ato “mashkull” të montuara në brendësi të pjesës së djathtë të veshur; më pas një mbyllje me anë të precinave “mashkull”nga jashtë të pjesës së djathtë në korrespondencë me precinat “femër” të mostrës në të majtë të veshur, duke realizuar në këtë mënyrë një mbyllje totalisht të padepërtueshme të ujit.

Në dy pjesët përpara përgjatë linjës së belit janë aplikuar dy xhepa të brendshëm të gjerë, me kapak të realizuar me tekstil dopio në pjesën e sipërme në drejtim transversal me dimensione; gjatësi rreth 19 cm. Astari i xhepit është realizuar me tekstil dopio ka lartësi rreth rreth 4 cm dhe gjatësi rreth 20 cm i borduar me anë të tegelit qepës një gjilpërësh përgjatë gjatësisë, ndërsa anët e shkurtëra janë përforcuar me anë të tegelit qepës dy gjilpërësh.

Të gjithë tegelat qepës janë fiksuar me anë të shiritit izolues, të padepërtueshëm nga uji.

Linjat fundore të mushamasë dhe mëngëve, kanë një kthim pale rreth 2 cm.

## 2. PRAPA

Është realizuar me tekstil me përbërje poliamidi të papërshkueshëm ndaj ujit, është me një pjesë. Përgjatë linjës së shpinës është realizuar një stampë fosforeshente, ngjyrë gri e argjentë, me shkrimin me gërma kapitale“ POLICIA BASHKIAKE – TIRANE ” me stampim me lartësi 8 cm (kjo lartësi është e ndryshueshme në bazë të prerjes).

Prapa gjithashtu, në dy linjat anësore, janë aplikuar dy çarje në drejtim vertikal me lartësi totale rreth 46 cm. Në pjesën e poshtme të çarjes është aplikuar një shirit velkrof “mashkull” me gjerësi rreth 5 cm. Pjesa e sipërme e çarjes është formuar nga një palosje nga i njëjti tekstil me atë të mushamasë me gjerësi rreth 7 cm, në brendësi të së cilës është aplikuar një shirit velkrofi “ femër ” me push përgjatë

gjithë gjatësisë së çarjes. Velkrofi ka gjerësi rreth 5 cm. Bashkimi i dy anëve të çarjes realizohet me anë të këtyre velkrofëve.

**3. MËNGËT**

Janë model "Reglan" dhe bashkohen me trupin e mushamasë nëpërmjet tegelit qepës në drejtim diagonal. Mëngët janë me një pjesë, të modeluara dhe bashkohen me anë të tegelit të poshtëm si dhe është aplikuar shiriti izolues përgjatë tegelit.

Në lartësinë e palosjes në distancë rreth 8,5 cm nga njëra- tjetra janë aplikuar dy preçina: një "mashkull" dhe një "femër", të cilat të bashkuara ndërmjet tyre bëjnë të mundur shtrëngimin e kyçit të dorës në rreth 1/3 e perimetrit.

Tek mëngët vendoset shirit fosforeshent ne ngjyrë gri të argjentë, rrethore, me gjerësi 3 cm.

**4. JAKA**

Është realizuar me tekstil dopio të njëttë me atë të mushamasë; ekstremitetet fundore të së cilës përfundojnë me majë. Jaka bashkohet me pjesët përpara dhe pjesën mbrapa me anë të tegelit qepës një

gjilpërësh. Tre drejtimet e lira të jakës janë përshkuar me anë të tegelit linear perimetral në distancë rreth 5 mm nga bordet. Në ektremitetin në të majtë të veshur në distancë rreth 1 cm nga bordi është aplikuar një almar ( gjuhëz ) në formë drejtkëndor i realizuar me të njëjtin tekstil dopio, me gjatësi rreth 10 cm dhe gjerësi rreth 2.8 cm . Në ekstremitetin e almarit si në pjesën përpara ashtu dhe prapa është realizuar velkrof " femër " me push me gjerësi rreth 2 cm dhe gjatësi rreth 4 cm për anë. Rreth 6 cm prapa alamarit ( gjuhëzës) është aplikuar një velkrof " mashkull " me dimensione 2 x 4 cm. I njëjti velkrof " mashkull " është aplikuar dhe në ekstremitetin e jakës në të djathtë të veshur rreth 6 cm nga bordi, duke bërë të mundur kështu mbylljen e jakës nëpërmjet alamarit (gjuhëzës) në të majtë të aplikuar. Në brendësi të jakës, përgjatë linjës fundore të saj është aplikuar një shtresë tekstili me të njëjtin tekstil e quajtur ndryshe dhe nënjakë, e cila përfundon me një kthim pale të brendshme të montuara me anë të tegelit qepës. Në pjesën e jashtëme të afërsi të tegelit bashkues të jakës me trupin e pelerinës,janë montuar tre preçina "mashkull"; të pozicionuara dy në skajet, ndërsa një i pozicionuar përgjatë linjës qendrore. Këto tre precina shërbejnë për montimin e kapuçit të heqshëm.

**5. KAPUÇI**

Është realizuar me të njëjtin tekstil si ai i mushamasë i padepërtueshëm nga uji. Është i përbërë nga dy pjesë në dy gjysmë koka të modeluara, të montuara me anë të tegelit qepës një gjilpërësh me shirit izolues i cili shërben mos depërtimin e ujit dhe është përshkuar nga tegeli qepës perimetral. Në linjën fundore me përjashtim të anëve të përparme në distancë rreth 13 cm është realizuar një kthim pale rreth 3 cm. Përgjatë kësaj linje janë aplikuar tre preçina " femër " në korrespondencë me tre preçinat " mashkull ", të aplikuar në jakë.

Anët e përparme janë realizuar me tekstil dopio dhe të fiksuara me anë të tegelit qepës një gjilpërësh me gjerësi rreth 13 cm dhe me lartësi rreth 12,5 cm, ku tekstili dopio shtrëngohet deri në një gjerësi rreth 3,5 cm që vazhdon përgjatë perimetrit të kokës. Pjesa fundore e anës me gjerësi rreth 4 cm përfundon me një çarje ,nëpër të cilën është ndërfutur një kordon elastik cili përfundon me një fiksues kordoni prej materiali plastik. Kordoni bën të mundur qëndrimin e kapuçit në bazë të formës së kokës.

Në anën e majtë përpara në brendësi është aplikuar një velkrof " femër " me dimensione rreth 7 x10 cm, ndërsa në anën e majtë të veshur përpara është aplikuar një velkrof "mashkull ".

Me anë të këtyre velkrofëve mbron si qafën ashtu dhe mjekrën e nga agjentët atmosferik.

**Amballazhimi,**

Paketimi i artikulli **“Mushama shiu”** bëhet duke e palosur dhe e futur mushamanë brenda në qese **PVC**-je trasparente. Futen në kuti sipas numrave një sasi e caktuar dhe vulosen nga firma përkatëse. Shkruhet sasia dhe viti prodhimit.

- Treguesi i përbërjes së tekstilit,viti i fabrikimit dhe instruksionet e larjes (mirëmbajtja).




Këto instruksione janë aplikuar dhe në etiketën në pjesën e brendshme të xhepit në të djathtë të veshur.

**NORMAT E LARJES :**




**TABELA E MASAVE**

( PËRMASAT E SHPREHURA NË CM – TOLERANCË +/- 3%)

| | **XS** | **S** | **M** | **L** | **XL** | **XXL** | **XXXL** | **4XL** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1/2 e Perimetrit të kraharorit (e matur nën sqetull) | 57 | 61 | 65 | 69 | 73 | 76 | 80 | 84 |
| Gjatësia e përgjithshme e pelerinës (nga supi deri në linjën fundore) | 97 | 104 | 115 | 122 | 127 | 132 | 137 | 142 |
| Gjatësi mënge (e matur nga pjesa e sipërme) | 73 | 76 | 79 | 82 | 85 | 86 | 86 | 86 |

**Skicimet bashkalidhur DST**

Shtojca11

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër*]

**PLANIFIKIMI I**
**KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

| Mall: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër | | |
|---|---|---|
| **Kontrata Nr.** | **Titulli i Kontratës** | **Përshkrim i shkurtër i kontratës** |
| **01** | | |
| **02** | | |
| **03** | | |
| **…** | | |

**Shtojca 12**

*( Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit*)

## SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet: **Uniforma dhe veshje të tjera speciale për Policinë Bashkiake**

| **Nr** | **Përshkrimi i mallrave** | **Njësia** | **Sasia** |
|---|---|---|---|
| 1 | Këmishë me mëngë të gjata | Copë | 1100 |
| 2 | Këmishë me mëngë të shkurtëra | Copë | 1100 |
| 3 | Këpucë gjysma, lëkurë | Palë | 500 |
| 4 | Këpucë lëkure, me qafa, trupe | Palë | 250 |
| 5 | Kostum dok – trikoton (1 xhaketë, 2 palë pantallona, 2 copë kapela) | Komplet | 250 |
| 6 | Kostum teritali: (1 xhaketë, 2 palë pantallona, 2 copë kapele) | Komplet | 200 |
| 7 | Kravatë perhure sintetike | Copë | 351 |
| 8 | Pantallona teritali, vere. | Copë | 497 |
| 9 | Pulovër (lesh + akrilik) | Copë | 300 |
| 10 | Rrip pantalloni, lëkurë e zezë | Copë | 180 |
| 11 | Xhup operacional | Copë | 250 |
| 12 | Rrip mesi sintetik, shërbimi – multifunksional | Komplet | 130 |
| 13 | Spaleta (dok i plastifikuar) | Palë | 501 |
| 14 | Xhup sintetik, kundra shiut. (Xhakavento) | Copë | 250 |
| 15 | Pelerina shiu | Copë | 50 |

**Afatet e lëvrimit:** Operatori fitues duhet të lëvrojë mallin sipas kërkesave dhe specifikimeve të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor brenda 60 ditëve pune nga data e lidhjes së kontratës. Malli duhet të dorëzohet në magazinën e Bashkisë Tiranë.

**Shtojca 13**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

**NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR[1]**

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik".

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

____________________________________________________________
____________________________________________________________
____________________________________________________________
____________________________________________________________
____________________________________________________________
____________________________________________________________
____________________________________________________________

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.
Me respekt
**< Emri >**

**Shtojca 14**

[ *Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor*]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

*[Data]*

Për: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]*

* * *

Procedura e prokurimit:
Numri i referencës së procedurës/lotit:
Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]*
Publikime të mëparshme *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]*
Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme
Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1.___________________________________ _______________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*
Vlera ________________________________
*(me numra dhe fjalë)*

2.___________________________________ _______________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*
Vlera ____________________________
*(me numra dhe fjalë)*
Etj.______________________________

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:
1.___________________________________ _______________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*
2.___________________________________ _______________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

___________________________________________________________________________

___________________________________________________________________________

_____________________________________________________________

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *[emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]* se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej *[shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*/pikët totale të marra *[_____]*është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit]* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda ____________ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë ______________________________

Ankesa: ka ose jo______________
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë ____________________________

* * *

[ Titullari i autoritetit kontraktor]

**Shtojca 15**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër*]

## FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

*[Data]*

Për: *[Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]*
1.___________________________________________
*2.* ___________________________________________
*3.*___________________________________________

* * *

Procedura e prokurimit: ______________________
Numri i referencës së procedurës/lotit:
Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*
Publikime të mëparshme *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]*
Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1.__________________________________ ______________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera ______________________________
*(me numra dhe fjalë)*
2.__________________________________ ______________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*
Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____________________________
*(me numra dhe fjalë)*
Etj.____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:
1.__________________________________ ______________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*
2.__________________________________ ______________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:
______________________________________________________________________________________
______________________________________________________________________________________
______________________________________________________________________

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se jane identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:
1.__________________________________ ______________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _______________/ Pikët totale të marra ____
*(me numra dhe fjalë)*
2.__________________________________ ______________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera ___________/Pikët totale të marra ____
*(me numra dhe fjalë)*
Etj.__

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë *[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit]*, brenda ____________ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë ______________________________

Ankesa: ka ose jo______________
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë ____________________________

**[Titullari i autoritetit kontraktor]**

**Shtojca 16**

## KUSHTET E PËRGJITHSHME
## Mallrat – Tender i Hapur

### Neni 1: Qellimi

1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen e Mallrave të prokuruara me anë të procedurës me negociim.

1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërise parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.

1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.

1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.

1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

### Neni 2: Përkufizime

2.1 "kontratë" do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga Dokumentat e Tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha shtojcat dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.

2.2 "çmim kontrate" do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.

2.3 "Incoterms" do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë detyrimet përkatëse, kostot, dhe risqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga shitësi tek bleresi.

2.4 "Lëvrimi" do të thotë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që mundësojnë marrjen e Mallrave në vendin e shpërndarjes siç specifikohet në kontratë si paketimi, transportimi, sigurimi, tarifat, procedura doganore, ngarkimi dhe shkarkimi, instalimi, mbledhja, bashkimi, kontrollimi i

veprimeve dhe mbikëqyrja e gjithë kësaj veprimtarie.

2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen Mallrat. Ky term kudo qe përdoret ka kuptim të njëjtë me ate te perkufizuar ne ligj.

2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon Mallrat.

2.7 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.

2.8 “Mallrat” do të thotë materialet e papërpunuara, produktet, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë, të lëngshme ose të gaztë.

2.9 “Shërbimet e lidhura me to” do të thotë shërbimet ndihmëse ose të paparashikuara të furnizimit të Mallrave, si transportimi, instalimi, mirëmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e Mallrave.

2.10 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Mallrat dhe Shërbimet e lidhura me to që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.

2.11 “Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një organ i posaçëm standardizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose përkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

**Neni 3: Hartimi i Kontratës**

3.1 Njoftimi i ofertës fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.

3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

**Neni 4: Praktikat e Korruptuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

4.1 Atoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.

4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ndonjë ent tjeter që ka marrë pjesë në përgatitjen e Dokumentave të Tenderit për këtë prokurim.

4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

**Neni 5: Informacioni Konfidencial**

5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.

5.2 Kontraktuesi mund t'i japë nënkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar për nënkontraktuesin të kryejë punën e tij sipas kontatës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nën-Kontraktuesin një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

**Neni 6: Pronësia Intelektuale**

6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetin Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.

6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Kontraktuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i parashtrojë Autoriteti Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdorë për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.

6.3 Kontraktuesi duhet të shkarkojë Autoritetin Kontraktor nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronësisë intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose shpërndarja e Mallrave sipas kontratës.

6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronësisë intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i Mallrave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

**Neni 7: Origjina e Mallrave**

7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së mallrave, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.

7.2 Kontraktuesi mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e mallrave.

7.3 Për qëllime verifikimi, "origjinë" do të thotë vendi ku mallrat janë nxjerrë, ose prodhuar. Mallrat janë prodhuar kur, nëpërmjet përpunimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.

7.4 Origjina e mallrave ka dallim nga kombësia e Kontraktuesit ose nenkontraktuesit që siguron mallrat.

**Neni 8: Qëllimi i Furnizimit dhe Përshtatshmëria e Mallrave me Specifikimet**

8.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat në përputhje me cilësinë, sasinë dhe llojin e specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.

8.2 Mallrat nuk janë në perputhje me kontratën, nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin e posaçëm të parashikuar në kontratë. Kur nuk është e mundur të përcaktohet një gjë e tillë, thuhet se Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin per te cilin sherbejne zakonisht sendet e tjera të të njëjtit lloj.

8.3 Nëse shitja është bërë në bazë të një modeli ose kampioni, shitësi (Kontraktuesi) duhet të dorëzojë sendet që kanë të njëjtat cilësi si të modelit ose kampionit.

**Neni 9: Përputhshmëria e Mallrave me Standardet Teknike**

9.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konform kodeve dhe Standardeve Teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet përkatëse ose në Standardet Teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktor.

9.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë dispozite tjetër e kontratës, kur nuk është përcaktuar asnjë Standard Teknik përkatës në specifikimet teknike, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike ndërkombëtare. Nëse nuk ekzistojnë Standarde Teknike ndërkombëtare, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike përkatëse Shqiptare.

9.3 Kontraktuesi nuk mban përgjegjësi për gabime në skicim, të dhëna, vizatim ose çdo aspekt tjetër të specifikimeve teknike të dhëna nga Autoriteti Kontraktor me përjashtim të rastit kur gabimi ishte aq i dukshëm sa Kontraktuesi duhet ta kishte parë dhe këshilluar Autoritetin Kontraktor për të.

9.4 Shitësi (Kontraktuesi) nuk mban përgjegjësi për defekte të Mallrave për të cilat Autoriteti Kontraktor ishte në dijeni në momentin e lidhjes së kontratës ose nuk ishte në dijeni për faj të tij, me përjashtim të rastit kur defektet kanë të bëjnë me cilesinë e Mallrave të specifikuar sipas kontratës ose përfaqësimin e reklamës se shitesit (Kontraktuesit).

**Neni 10: Pjesët e Këmbimit**

10.1 Nëse është e parashikuar në kontratë, Kontraktuesi duhet të përfshijë me Mallrat e lëvruara një sasi pjesësh këmbimi, në përputhje me specifikimet teknike dhe çdo dispozitë përkatëse të kontratës.

10.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe, pjesët e këmbimit do të dorëzohen bashkë me Mallrat.

10.3 Kontraktuesi duhet të garantojë disponueshmërinë e pjesëve të këmbimit për një periudhë të specifikuar në ofertën e tij dhe të barabartë me jetëgjatësinë e përdorimit të Mallrave.

10.4 Në rast të një vendimi të ndërprerjes së prodhimit të pjesëve të këmbimit, Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor brenda një kohe të arsyeshme/mjaftueshme për t'i lënë mundësi atij që të prokurojë sasi të mjaftueshme për përdorim të mëvonshëm.

10.5 Pas ndërprerjes së prodhimit të pjesëve të këmbimit, Kontraktuesi duhet t'i japë pa pagesë Autoritetit Kontraktor, nëse ai e kërkon, çdo prodhim, vegël, skicim të pjesëve të këmbimit të përdorura në prodhimin dhe mirëmbajtjen e Mallrave.

**Neni 11: Ambalazhimi**

11.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat të vendosura dhe të ambalazhuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.

11.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë nen tjetër i kontratës, mund të thuhet se Mallrat nuk janë vendosur dhe paketuar në përputhje me kontratën nëse ato nuk janë vendosur dhe paketuar në të njëjtën mënyrë që bëhet zakonisht për gjërat e të njëjtit lloj ose, nëse mënyra e zakonshme nuk është e disponueshme, në një mënyrë që është e përshtatshme për ruajtjen dhe mbrojtjen e Mallrave.

**Neni 12: Testimet dhe Inspektimet**

12.1 Kontraktuesi duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kosto e këtyre testimeve dhe inspektimeve duhet të financohet tërësisht nga Kontraktuesi brenda kushteve të çmimit të kontratës

12.2 Me shpenzimet e tij, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të ndjekë testimet dhe/ose inspektimet.

12.3 Autoriteti Kontraktor gjithashtu mund t'i kërkojë Kontraktuesit të bëjë testime ose inspektime shtesë të paparashikuara në kontratë por të gjykuara të nevojshme për të verifikuar se Mallrat janë konform specifikimeve dhe kushteve të kontratës. Autoriteti kontraktor do të mbajë përgjegjësi për koston e këtyre testimeve. Më tej, nëse këto teste ndalojnë progresin e punës së Kontraktuesit, Autoriteti Kontraktor do të pranojë të ndryshojë grafikun e lëvrimit.

12.4 Autoriteti Kontraktor do të refuzojë çdo Mall që nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është konform specifikimeve teknike dhe kushteve të kërkuara në zbatimin e kontratës.

12.5 Ekzekutimi i testeve, apo inspektimi i Mallrave nuk e shkarkojnë Kontraktuesin nga garancitë apo detyrimet e tjera sipas kontratës.

**Neni 13: Kushtet e Dorëzimit**

13.1 Kontraktuesi është i detyruar të kryejë të gjitha aktivitetet dhe veprimet e dorëzimit përveçse kur Kontraktuesi përjashtohet në mënyrë specifike nga një aktivitet ose veprim i tillë nga ndonjë dispozitë e kontratës. Nëse një Incoterm përdoret për të përshkruar detyrimet e palëve, termi do të ketë kuptimin që i ka dhënë botimi i fundit i *Incotermave* botuar nga Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.

13.2 Vendi i dorëzimit të Mallrave do të jetë sipas specifikimit të kontratës.

13.3 Koha e dorëzimit të Mallrave dhe data e përfundimit të Shërbimeve të lidhura me to do të jetë sipas specifikimit në kontratë.

13.4 Dorëzimi i Mallrave duhet të bëhet gjatë orarit të punës me përjashtim të rastit kur kjo kërkesë bie ndesh me ndonjë dispozitë të kontratës.

13.5 Kontraktuesi është i detyruar të njoftojë Autoritetin Kontraktor brenda një periudhe kohore të arsyeshme për dorëzimin e Mallrave përpara arritjes së tyre.

**Neni 14 Transportimi i Mallrave**

14.1 Kontraktuesi është i detyruar të sigurojë ngarkimin dhe transportimin e Mallrave siç kërkohet, me qëllim që të plotësojë afatet dhe kushtet e dorëzimit të specifikuara në kontratë.

14.2 NëAurtoriteti Kontraktor është i detyruar të marrë Mallrat nga ndonjë mjet transporti apo agjenci transporti, Kontraktuesi duhet të japë lajmërim paraprak të arsyeshëm për transportin dhe t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha dokumentat e nevojshme për marrjen e Mallrave.

14.3 Nëse shitësi, [Kontraktuesi] është i detyruar t'i dorëzojë mallrat në mjetin e transportit në një vend të specifikuar në kontratë, risku i humbjes kalon tek Autoriteti Kontraktor vetëm kur mallrat i dorëzohen mjetit të transportit në vendin e specifikuar. Fakti se shitësi [Kontraktuesi] është i autorizuar të mbajë dokumentat përfaqësuese të mallrave nuk influencon në kalimin e rriskut.

**Neni 15: Siguracioni**

15.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Kontraktuesi duhet të sigurojë qëe Mallrat që do të dorëzohen sipas kontratës janë plotësisht të siguruara ndaj humbjes ose dëmtimit gjatë transportit, magazinimit ose dorëzimit të tyre.

**Neni 16: Verifikimi dhe Pranimi i Mallrave**

16.1 Përpara pranimit, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të verifikojë, inspektojë dhe testojë Mallrat. Këto veprime duhet të kryhen menjëherë pas dorëzimit të Mallrave. Kontraktuesi ka të drejtë të marrë pjesë në këtë proces dhe të shqyrtojë raportet përkatëse të prërgatitura nga Autoriteti Kontraktor ose agjentët e tij.

16.2 Autoriteti Kontraktor pranon ose refuzon Mallrat menjëherë pas dorëzimit duke njoftuar me shkrim Kontraktuesin në lidhje me vendimin e tij për të pranuar ose refuzuar Mallrat.

**Neni 17: Garancitë**

17.1 Kontraktuesi garanton se Mallrat janë të reja, të papërdorura dhe të modeleve të fundit dhe se ato trupëzojnë përmirësimet e fundit në skicim dhe materiale, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë.

17.2 Shitësi (Kontraktuesi) mban përgjegjësi për çdo defekt ose mospërputhje që ekziston në momentin kur risku kalon tek Autoriteti Kontraktor, edhe kur defekti shfaqet pas këtij momenti.

17.3 Shitësi (Kontraktuesi) mban përgjegjësi për mospëputhjen që verifikohet pas momentit të treguar në paragrafin e mësipërm dhe që vjen nga mospërmbushja e ndonjë detyrimi, duke përfshirë garancinë që Mallrat duhet të jenë të përshtatshme për përdorimin e tyre të zakonshëm dhe

specifik për një periudhë të caktuar kohe, ose se ato do të ruajnë cilësitë dhe karakteristikat e caktuara.

17.4 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë ose në ligj, Autoriteti Kontraktor humbet të drejtën e tij për të kundërshtuar lidhur me të metat e sendit nëse ai nuk i denoncon ato të shitësi (Kontraktuesi), duke specifikuar natyrën e tyre, brenda dhjetë ditëve nga zbulimi i tyre.

17.5 Autoriteti Kontraktor s i mundëson Kontraktuesit të gjitha mjetet e nevojshme për të inspektuar këto defekte.

17.6 Pas marrjes së këtij njoftimi, Kontraktuesi duhet të riparojë menjëherë ose të zëvendësojë Mallrat defektoze ose pjesët e tyre pa pagesë shtesë për Autoritetin Kontraktor.

17.7 Nëse pas marrjes së njoftimit, Kontraktuesi dështon në rregullimin e defektit brenda një periudhe të arsyeshme, Autoriteti Kontraktor mund të ndërmarrë veprime për rregullimin e nevojshëm, me shpenzimet e Kontraktuesit.

17.8 Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor humbet të drejtën për të kundërshtuar për të metat e sendit nëse ai nuk e ushtron të drejtën e tij brenda dy vjetësh nga data kur sendet i janë dorëzuar atij, po qe se ky afat nuk bie në kundërshtim me kohëzgjatjen e garancisë kontraktore.

17.9 Shitësi (Kontraktuesi) nuk mund të shfrytëzojë rregullat e parashikuara ketu nëse defektet kanë të bëjnë me fakte të njohura prej tij ose që nuk mund të ishin të panjohura për të dhe që nuk i janë vënë në dukje Autoritetit Kontraktor.

**Neni 18: Çmimi i Kontratës**

18.1 Çmimi i kontratës është çmimi i dhënë në ofertën e Kontraktuesit dhe i pranuar nga Autoriteti Kontraktor.

18.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, çmimi i kontratës përfshin kostot dhe tarifat, duke përfshirë taksat dhe tarifat doganore të lidhura me dorëzimin e Mallrave, pagesa për transportin, sigurimin, instalimin, testimet, ngarkimin, shkarkimin, udhëzimet, manualet dhe dokumentat në gjuhën e specifikuar dhe të nevojshme për përdorim të rrëgullt, mirëmbajtje dhe riparime të Mallrave. Vlera e taksave dhe tarifave duhet të përcaktohet sipas legjislacionit përkatës, në fuqi 28 ditë para hapjes së ofertave.

**Neni 19: Afatet e Pagesës**

19.1 Çmimi i kontratës, duke përfshirë çdo pagesë paraprake, duhet të paguhet në kohë siç specifikohet në kontratë.

19.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, pagesa duhet bërë në monedhë Shqiptare. Kursi i këmbimit të monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankes së Shqiperise i fiksuar në ditën e dërgimit për botim të njoftimit të kontratës.

19.3 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kërkesa e Kontraktuesit për pagesë duhet t'i bëhet Autoritetit Kontraktor me shkrim. Për çdo kërkesë, Kontraktuesi duhet të

paraqesë origjinalin dhe kopjen së bashku me një listë të sendeve që përshkruan Mallrat e dorëzuara dhe shërbimet e kryera.

19.4 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, pagesa për Mallrat do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga dita që janë pranuar Mallrat ose nga dita e marrjes së kërkesës për pagesë cilado të jetë më vonë.

19.5 Data e pagesës do të jete dita që fondet xhirohen nga llogaria e Autoritetit Kontraktor.

**Neni 20: Vonesa në Bërjen e Pagesës**

Në rast të verifikimit të vonesave në kryerjen e pagesave nga ana e Autoritetit Kontraktor, megjithëse kontraktuesi ka përmbushur të gjitha detyrimet e tij në përputhje me kushtet e kontratës, detyrimet e prapambetura dhe kamatëvonesat përkatëse do të kryhen në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare".

**Neni 21: Nryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve**

21.1 Nëse pas datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj, rregullore, urdhëresë, urdhër ose procedurë me efektin e ligjit në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi, nxirret ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit, ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa Kontraktuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

**Neni 22: Forca Madhore**

22.1 Kontraktuesi nuk mban përgjegjësi për humbjen e sigurimit të kontratës, dëmeve të likuiduara ose ndërprerjen për mosplotësim, nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në zbatimin e detyrimeve të tij sipas kontratës vijnë si rezultat i verifikimit te rasteve të Forcës Madhore.

22.2 Për qëllimet e këtij neni "Forcë Madhore" do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të Kontraktuesit mbi fajin ose neglizhimin dhe e paparashikueshme nga ana e tij. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk janë të limituara nga, veprimet e Autoritetit Kontraktor qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmbytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.

22.3 Nëse ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjëherë Autoritetin Kontraktor. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktor jep direktiva të ndryshme, Kontraktuesi duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.

**Neni 23: Vonesa në Zbatim dhe Zgjatja e Afatit**

23.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe, Kontraktuesi duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.

23.2 Me përjashtim të rasteve kur Autoriteti Kontraktor është dakord për zgjatje të afatit të kontratës, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të likuidojë dëmet për vonesën në zbatim nëse Kontraktuesi dështon në dorëzimin e Mallrave brenda periudhës së zbatimit të specifikuar në kontratë.

23.3 Autoriteti Kontraktor mund të zbresë shumën e dëmeve të likuiduara që duhet paguar nga shuma e pagesës ndaj Kontraktuesit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktor duhet të njoftojë Kontraktuesinme shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.

23.4 Autoriteti Kontraktor pranon zgjatjen e afatit në rastin e Forcës Madhore.

23.5 Autoriteti Kontraktor mund pranojë zgjatjen e afatit edhe në rrethana të tjera nëse është në interesin publik për ta bërë këtë. Ne rast se Kontraktuesi ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, Kontraktuesi duhet të njoftojë me përpikmëri Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkakun dhe datën e propozuar të dorëzimit ose përfundimit. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi.

**Neni 24: Likuidimi i Dëmeve për Dorëzimin e Vonuar**

24.1 Dëmet e likuiduara për dorëzimin e vonuar do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore::

a) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlere do te llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontrates.

b) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlere do te llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontrates.

c) Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do te llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontrates.

**Neni 25: Negociatat dhe Amendamentet**

25.1 Palët nuk mund të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë elementi të kontratës që do të sillnin ndryshime thelbësore në kushtet bazë për përzgjedhjen e Kontraktuesit.

25.2 Asnjë amendament ose ndryshim tjetër i kontratës nuk është i vlefshëm nëse ai nuk bëhet me shkrim apo nuk ka një datë të përcaktuar, si edhe nëse ai nuk i referohet shprehimisht kontratës apo nuk nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar i Kontraktuesit dhe Autoriteti Kontraktor.

25.3 Çdo heqje dore nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqësues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.

**Neni 26: Ndryshimi i Porosisë**

26.1 Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të porosisë Mallra ose Shërbime shtesë deri në një masë që nuk i kalon 20% të çmimit total të kontratës. Çdo porosi shtesë duhet të bëhet në mënyrë

konsistente më rregullat dhe procedurat e parashikuara në Ligjin mbi Prokurimin Publik.

**Neni 27: Ndërprerja për Mosplotësim**

27.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:

a) Kontraktuesi dështon në dorëzimin e Mallrave brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose,
b) Kontraktuesi dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.

27.2 Autoriteti Kontraktor duhet të njoftojë me shkrim Kontraktuesin për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japë Kontraktuesit 15 ditë të ndreqë mosplotësimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime korruptive ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.

**Neni 28: Ndërprerja për Shkak të Falimentimit**

28.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse Kontraktuesi falimenton ose bëhet i paaftë të paguajë.

28.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen.

**Neni 29: Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik**

29.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.

29.2 Autoriteti Kontraktor duhet të njoftojë me shkrim Kontraktuesin për ndërprerjen..

29.3 Autoriteti kontraktor duhet të paguajë Kontraktuesin për të gjitha Mallrat e pranuara dhe Shërbimet e lidhura me to të kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë Kontraktuesit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjesshme të Mallrave dhe Shërbimeve të lidhura me to. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, Kontraktuesit do t'i kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

**Neni 30: Nënkontraktimi**

30.1 .Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është në formën e një marrëveshjeje të shkruar me anë të së cilës kontraktori i beson kryerjen e një pjese të detyrimeve të kontratës së tij një pale të tretë.

30.2 Kontraktori nuk duhet të nënkontraktojë pa aprovimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktor dhe jo më shumë se 40% të vlerës së kontratës. Kontraktori duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor për elementet e kontratës që nënkontraktohet dhe dokumentacionin që provon aftësinë e nën kontraktorit. Autoriteti Kontraktor duhet të lajmërojë kontraktorin për vendimin e tij, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke shprehur arsyet nëse e aprovon apo jo atë.

30.3 Çdo nënkontraktor ka të drejtë të marrë pjesë në prokurimin publik sipas Ligjit mbi Prokurimin

Publik. Autoriteti mund të parashikojë pagesa direkte tek nënkontraktori për mallrat që do të furnizojë.

30.4 Kontraktori mbetet plotësisht përgjegjës për zbatimin e kontratës pavarësisht nga sjellja e nënkontraktorit.

**Neni 31: Transferimi i të Drejtave**

31.1 Kontraktuesi nuk mund të transferojë, tërësisht ose pjesërisht, detyrimet e tij sipas kontratës me përjashtim kur jepet miratimi paraprak i Autoritetit Kontraktor.

**Neni 32: Sigurimi i Kontratës**

32.1 Përpara nënshkrimit të kontratës, kontraktuesi duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor sigurimin e kontratës në shumën dhe formën e kërkuar.

32.2 Shuma e sigurimit të kontratës duhet t'i paguhet Autoritetit Kontraktor si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i Kontraktuesit në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

32.3 Garancia e sigurimit të kontratës do t'i kthehet Kontraktuesit jo më vonë se 30 ditë pas datës së pranimit të Mallrave. Megjithatë, pesë (5) përqind e depozitës do të mbahet deri në përmbushjen e kënaqshme të detyrimeve të kontratës.

**Neni 33: Baza Ligjore**

33.1 Kontrata do të rregullohet dhe interpretohet sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

**Neni 34: Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve**

34.1 Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarërveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrëveshje me negociata direkte.

34.2 Në se palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes ose konfliktit, problemet do të konsiderohen me anë të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

**Neni 35: Përfaqësimi i Palëve**

35.1 Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose post organizativ, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me ekzekutimin e kontratës.

35.2 Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqësuesit të palës. Nëse njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marrë përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.

35.3 Palët mund të emërojnë persona ose njësi organizative shtesë për të përfaqësuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta, rast në të cilin njoftimi me shkrim duhet dhënë dhe duhet të përcaktojë

shtrirjen e autoritetit të përfaqësuesit.

**Neni 36: Lajmërimet**

36.1 Çdo lajmërim i dhënë nga njëra palë tjetrës sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë.

36.2 Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

**Neni 37: Llogaritja e Afateve**

37.1 Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike.

**Shtojca 17**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

## KUSHTET E VEÇANTA
## Mallrat – Procedurë e Hapur

Kushtet e veçanta të Kontratës hartohen në përputhje me objektin konkret të kontratës. Në rast se ka mospërputhje midis KPK dhe KVK do të mbizotërojne Kushtet e veçanta të kontratës.

**Neni 1: Përkufizime**

1.1 Autoriteti Kontraktor është ___________________________________________

1.2 Kontraktuesi është ___________________________________________________

**Neni 2: Sigurimi i Kontrates**

2.1 Sigurimi i Kontratës në shumën prej *(10% të vlerës së ofertës)* duhet të ofrohet nga Kontraktuesi për të siguruar egzekutimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

2.2 Sigurimi i Kontratës do t'i lëshohet ose kthehet, menjehere Kontraktuesit sipas formularit të mëposhtëm:_________________________________________
_______________________________________________________________
_______________________________________________________________

**Neni 3: Fillimi i Zbatimit**

3.1 Zbatimi i kontratës duhet të fillojëe më __________. Nëse data nuk është e përcaktuar, zbatimi do të fillojë në datën që Kontraktuesi nënshkruan formularin e kontratës.

**Neni 4: Inspektimet dhe Testimet**

4.1 Inspektimet dhe testimet para pranimit të Mallrave do të bëhen:______________________
_______________________________________________________________
_______________________________________________________________
_______________________________________________________________
_______________________________________________________________

**Neni 5: Kushtet e Dorëzimit**

5.1 Data (t) dhe vendi (et) i dorëzimit të Mallrave do të bëhet sipas Grafikut të Lëvrimit të parashikuar në këtë kontratë.

5.2 Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor______ ditë para çdo dorëzimi të Mallrave.

5.3 Lajmërimi i dorëzimit duhet të bëhet me shkrim, faks, postë, e-mail etj, tek:____________
________________________________________________________________________________
________________________________________________________________________________

5.4 Nëse Autoriteti Kontraktor i merr Mallrat nga një palë e tretë, lajmërimi i dorëzimit duhet të përfshijë listën e dokumentave të nevojshme për marrjen e Mallrave dhe të tregojë se ku dhe kur do t'i jepen dokumentat Autoriteti Kontraktor.

5.5 Nëse Autoriteti Kontraktor i merr Mallrat nga një palë e tretë, Kontraktuesi duhet të dorëzojë të gjitha dokumentat e nevojshme për marrjen e Mallrave tek:______________
________________________________________________________________________________

**Neni 6: Kushtet e Pagesës**

6.1 Pagesa e Mallrave duhet bërë brenda _________ ditëve nga data e pranimit të Mallrave ose nga data e marrjes se kerkeses me shkrim te pagesës, sado vone qe te vije. Nëse nuk është specifikuar, periudha kohore do të jetë 30 ditë.

6.2 Monedha e pagesës do të jetë ______. Nëse është lënë e paplotësuar, pagesa do bëhet me monedhën Shqiptare.

**Neni 7. Pagesa Paraprake**

7.1 Përqindja e pagesës paraprake do të jetë _____. Nëse nuk është specifikuar, Kontraktuesi nuk do të marrë pagesë paraprake.

7.2 Nëse është premtuar një pagesë paraprake, avanca do të paguhet brenda ______ ditëve nga marrja e sigurimit te kontrates.

7.3 Nëse jepet pagesa paraprake, shuma do të hiqet nga pagesa që duhet t'i jepet Kontraktuesit sipas formulës së mëposhtme:________________________________________
________________________________________________________________________________

**Neni 8. Shërbimet në Lidhje me to**

8.1 Kushtet e veçanta të mëposhme do të zbatohen për kryerjen e pagesës së shërbimeve të lidhura
________________________________________________________________________________
________________________________________________________________________________
________________________________________________________________________________

**Neni 9. Zbritja e garancisë së kontratës**

9.1 Nëse parashikohet zbritje periodike të garancisë së kontratës ajo kryhet si më poshtë
______________________________________________________________________________
______________________________________________________________________________

Nëse nuk plotësohet, garancia mbetet e pandryshuar.

**Shtojca 18**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

**FORMULARI I PUBLIKIMIT TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË NËNSHKRUAR**

Seksioni 1 **Autoriteti Kontraktor**

**1.1 Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor**

Emri ______________________________________________

Adresa ______________________________________________

Tel/Fax ______________________________________________

E-mail ______________________________________________

Faqja në Internet ______________________________________________

**I.2 Lloji i autoritetit kontraktor:**

Institucion Qëndror Institucion i Pavarur

Njesi e Qeverisjes Vendore Tjetër

**Seksioni 2. Objekti i Kontratës**

**2.1 Numri i referencës së procedurës/lotit__________**

**2.2 Lloji i "Kontratave Publike për Mallra"**

Blerje Qira Leasing Blerje me këste Një kombinim i tyre

**2.3 Kontratë në bazë të Marrëveshjes Kuadër**

Po Jo

**Nëse Po, lloji i Marreveshjes Kuadër**

**Me 1 Operator Ekonomik**

**Me disa operatorë ekonomikë**

**Të gjitha kushtet janë të përcaktuara** Po Jo

**2.4 Përshkrim i shkurtër i kontratës**

1 Fondi limit _______________________________________________

2. Burimi i Financimit _________________________________________

3. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër________________________

**2. 5 Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:**

Kohëzgjatja në **muaj ose ditë**

ose

duke filluar nga // me përfundim në //

**2.6 Ndarja në LOTE:**

Po Jo

*Nëse Po,* numri i LOTEVE:

**2.7 Opsionet:**

Numri i rinovimeve të mundshme(nëse ka):

ose: nga në

**2.8 Kontrate me nenkontraktim:**

Po Jo

**Seksioni 3.** **<u>Procedura</u>**

**3.1 Lloji i procedurës: E Hapur**

**3.2 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:**

A) **çmimi më i ulët**

*ose*

B) **oferta ekonomikisht më e favorshme**

lidhur me rëndësinë: Çmimi **pikë**

etj. **pikë**

**3.3 Numri i ofertave të dorëzuara:**

**Numri i ofertave të rregullta:**

**3.4. Gjatë procesit të prokurimit në fushen e Teknologjisë të Informacionit dhe Komunikimit (TIK) janë përdorur standartet e përgatitura nga Agjencia Kombetare e Shoqërise së Informacionit:**

Po Jo

**3.5. Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë të Informacionit dhe Komunikimit (TIK), në rastin kur standartet janë të paaplikueshme, është marrë miratimi paraprak nga Agjencia Kombetare e Shoqërisë së Informacionit**

Po Jo

**Seksioni 4 Informacion mbi kontratën**

**4.1 Numri i Kontratës: _______________Data e Kontratës //**

**4.2 Emri dhe adresa e kontraktorit**

Emri ____________________________________________

Adresa ____________________________________________

Tel/Fax ____________________________________________

E-mail ____________________________________________

Faqja e Internetit ____________________________________________

4.2.1 **Emri dhe adresa e nenkontraktorit/eve**

Emri ____________________________________________

Adresa ________________________________________________

Tel/Fax ________________________________________________

E-mail ________________________________________________

Faqja e Internetit ________________________________________________

**4.3 Vlera totale përfundimtare e kontratës** *(duke përfshirë lotet opsionet dhe nenkontraktimin)*:

Vlera ________________ *(pa TVSH)* Monedha __________

Vlera ________________ *(me TVSH)* Monedha __________

**4.3.1** Vlera totale **e nenkontraktimit : ____**

Vlera ________________ *(pa TVSH)* Monedha __________

Vlera ________________ *(me TVSH)* Monedha __________

**4.4 Informacione shtesë**

________________________________________________________________________________

________________________________________________________________________________

Data e shpërndarjes së këtij njoftimi //

**Shtojca 18/1**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike]

**1.Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor**

Emri ______________________________________________

Adresa ______________________________________________

Tel/Fax ______________________________________________

E-mail ______________________________________________

Faqja në Internet ______________________________________________

**2. Lloji i procedurës:** ______________________________________________

**3. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër**________________________

**4.Numri i referencës së procedurës/lotit**_____________________________

**5. Fondi limit** ______________________________________________

**6. Vlera totale përfundimtare e kontratës** *(duke përfshirë lotet opsionet dhe nenkontraktimin)*:

Vlera _______________ *(me TVSH)* Monedha __________

Vlera e nenkontraktimit______________*me Tvsh* Monedha __________________

**7. Data e lidhjes së kontratës** ____________

**7. Emri dhe adresa e kontraktorit /nenkontraktorit**

Emri ______________________________________________

Adresa ______________________________________________

Nr. NIPT ______________________________________________

**Shtojca 19**

[*Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*]

[ *Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik*]

## FORMULARI I SIGURIMIT TË KONTRATËS

*[Data]*

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*
Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit: *[lloji i procedurës ]*
Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[ objekti]*
Publikimi *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, dhe me kusht që [*emri i ofertuesit të përcaktuar fitues*] t'i jetë akorduar kontrata,

Ne vërtetojmë se [*emri i ofertuesit të përcaktuar fitues*] ka derdhur një depozitë pranë [*emri dhe adresa e bankës / kompanisë së sigurimeve*] në një shumë prej [*monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra*] si kusht për sigurimin e ekzekutimit të kontratës, që do të nënshkruhet me [*emri i autoritetit kontraktor*]

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [*emri i autoritetit kontraktor*] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mos-përmbushjen e kushteve të kontratës.

Ky Sigurim është i vlefshëm deri në zbatimin plotë të kontratës.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimeve]

**Shtojca 20**

## FORMULARI I ANKESËS PRANE AUTORITETIT KONTRAKTOR

***Ankesë drejtuar:*** ***Autoriteti Kontraktor***

**Seksioni I. Identifikimi i Ankimuesit**

*Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (psh, si individ, në partneritet, në bashkëpunim, në bashkim shoqërish).*

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

Adresa

| | | |
|---|---|---|
| Qyteti | Shteti | Kodi Postar/Kodi Zip |

| | |
|---|---|
| Nr. Telefoni (duke përfshirë edhe prefiksin e zonës) | Nr. Faksi (duke përfshirë edhe prefiksin e zonës) |

E-mail

Emri dhe pozicioni i zyrtarit të autorizuar që plotëson ankesën (ju lutem, shtypeni)

| | |
|---|---|
| Firma e zyrtarit të autorizuar | Data (viti/muaji/dita) |
| Nr. Telefoni (duke përfshirë prefiksin e zonës) | Nr. Faksi (duke përfshirë prefiksin e zonës) |

**Seksioni II. Informacion për Procedurën**

**1. Numër Identifikimi**

*Plotësoni numrin e kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentat e tenderit, duke përfshirë* ***llojin e procedurës së përdorur*** *për prokurimin në fjalë (psh, Kërkesë për Propozime(KP), Procedurë e Hapur(PH), Procedurë e Kufizuar(PK), Procedurë me Negociim(PN), Shërbim Konsulence (SHK), Konkurs Projektimi (KP).*

**2. Autoriteti Kontraktor**
*Emri i autoritetit kontraktor që administron procesin e prokurimit.*

**3. Vlera e Përllogaritur e Prokurimit**
*Llogaritja e vlerës së kontratës (shuma e shprehur në shifra dhe fjalë)*

**4. Objekti i Kontratës**
*Përshkrim i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve që blihen.*

**5. Afati Përfundimtar për Dorëzimin e Ofertës**
*Afati përfundimtar për dorëzimin e ofertave.*

Data (viti/muaji/dita)

**6. Data e Përcaktimit të Kontratës Fituese**

Data (viti/muaji/dita) nëse zbatohet

**Seksioni III. Përshkrimi i ankesës**

**1. Baza Ligjore e Ankesës**
(shkruani shkeljen ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumenta, etj)

**2. Deklaratë e Hollësishme e Fakteve dhe Argumenteve**

*Jepni një deklaratë të hollësishme të fakteve dhe argumenteve që mbështesin ankesën tuaj. Për çdo arsye të ankesës specifikoni datën në të cilën u vutë në dijeni për faktet e lidhura me arsyet e ankesës. Përmendni edhe seksionet perkatëse të dokumentave të tenderit, nëse zbatohen. Përdorni faqe shtesë, nëse është e nevojshme.*

**3. Lista e Shtojcave**

*Që një ankesë të konsiderohet e dorëzuar, ajo duhet të jetë e plotë. Bashkangjisni një kopje të lexueshme të të gjithë dokumentave që kanë lidhje me ankesën tuaj dhe një listë të të gjithë këtyre dokumentave. Dokumentat duhet të përfshijnë normalisht* ***çdo njoftim të publikuar, të gjitha dokumentat e tenderit, me të gjitha ndryshimet dhe shtojcat, propozimin tuaj .*** *Përcaktoni se cili prej informacioneve është konfidencial, nëse ka të tillë. Shpjegoni se përse informacioni është i tillë, ose dorëzoni një version të dokumentave përkatëse me pjesët konfidenciale të hequra dhe një përmbledhje të përmbajtjes.*

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës për prokurimin, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe disa kopje shtesë, pranë **autoritetit kontraktor**

Shënim: Për ankesat pranë Komisionit të Prokurimit Publik duhet ti referoheni Formulari të Ankesës se nxjerrë nga ky institucion.

**Nr. Faks:**
**E-mail:**

**Nënshkrimi dhe Vula e ankuesit**

**Shtojca 21**

**DRAFTI I MARRËVESHJES KUADËR**
( KU TË GJITHA KUSHTET JANË TË PËRCAKTUARA)
**PËR PUNË / MALLRA / SHËRBIME**

[Përdorimi i ketij draft marrëveshje është detyruese për të gjitha Autoritetet Kontraktore që do të përdorin marrëveshjen kuadër)

**Nr __**

**DATA:**

Kjo kontratë lidhet më [*data*], midis [*emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor*] tani e tutje të referuar si "Autoriteti Kontraktor" dhe [*emri dhe adresa e Kontraktuesit*] të përfaqësuar nga [*përfaqësuesi*], tani e tutje i quajtur si "Kontraktuesi".

Kontraktori, me anë të ofertës së tij, me datë [*data*] bie dakord të furnizojë mallrat, ashtu siç janë të specifikuara në kushtet e përcaktuara në:

- Këtë kontrate
- Formularin e Deklarimit të Ofertës, të paraqitur nga Ofertuesi
- Specifikimet Teknike
- Formularin e çmimit të ofertës

Të gjitha këto dokumenta të bashkangjitur përbëjnë pjesë integrale të kësaj kontrate.

**Neni 1 Objekti**

1.1 Objekti i marreveshjes kuadër është të përcaktojë kushtet, përfshirë çmimet per njësi dhe rregullat për dorëzimin e mallrave/sherbimeve/puneve në vijim.

[përshkrimi i përgjithshëm]

1.2 Marrëveshja kuadër do të zbatohet me dërgimin e ftesave për ofertë tek operatorët ekonomikë, palë në marrëveshje. P.sh. kurdoherë që Autoriteti Kontraktor i përfshirë në këtë marreveshje, do të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate, duhet që të dërgojë "ftesën për ofertë" tek kontraktuesi, duke specifikuar listën me artikuj për furnizim me sasitë e tyre përkatëse.

1.3 Sasitë e parashikuara, janë vetëm sasi orientuese dhe NUK e kushtëzojnë Autoritetin Kontraktor për t'i blerë ato. Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të blejë më pak apo më shumë sasi se sa ato te parashikuara.

1.4 Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë kompensimi dhe NUK do t'i lejohet të bëjë ndryshime të çmimeve të njësisë, për shembull në rast se autoriteti kontraktor

vendosë të blejë më pak apo më shumë sasi se sa ato të specifikuara dhe/ose në rast se autoriteti kontraktor vendos të mos blejë asnjë nga këto sasi për disa artikuj.

1.5 Kohëzgjatja e marrëveshjes kuadër:

________________________

**Neni 2 Çmimi**

2.1 Çmimet për njësi për punë/mallra /shërbime janë treguar në Formularin e Cmimit të Ofertës.

2.2 Çmimet e njësive duhet të jenë fikse dhe nuk duhet t'i nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura në këtë marrëveshje kuadër.

**Nënshkrimet dhe Datat**

| **Për Kontraktuesin** | | **Për Autoritetin Kontraktues** | |
|---|---|---|---|
| **Emri:** | | **Emri:** | |
| Pozita: | | Pozita: | |
| Nënshkrimi: | | Nënshkrimi: | |
| Data: | | Data: | |
| **Vula:** | | **Vula:** | |

**Shtojca 22**

## DRAFTI I MARRËVESHJES KUADËR

## ( KU JO TË GJITHA KUSHTET JANË TË PËRCAKTUARA)
## PËR PUNË / MALLRA / SHËRBIME

**Emri i Autoritetit Kontraktues,**

Dhe

**Emri i Kontraktuesit**

Bien dakord si vijon:

**Të nënshkruajnë këtë Marrëveshje kuadër për objektin :** < vendosni titullin > me numrin identifikues : <*vendosni Numrin e Prokurimit*>

**Neni 1 Objekti**

1.1 Objekti i kësaj marreveshje kuadër është të vendosë rregullat për kontratat të cilat do të lidhen përmes procesit të mini-konkursit vetëm ndërmjet operatorëve ekonomike që janë palë e kësaj marrëveshje kuadër.

1.2 Kjo marrëveshje kuadër nuk është një kontratë në vete, por përcakton kushtet për kontratat që do të lidhen në bazë të saj.

1.3 Kontraktuesi është vetëm një nga palët e marrëveshjes kuadër.

**Neni 2 Detyrimet e Palëve**

2.1 Autoriteti Kontraktues, palë në këtë marrëveshje, do t'i dërgojë kontraktuesit "Ftesën për Oferte" kurdo që paraqitet nevoja për punë/mallra/shërbime.

2.2 Kontraktuesi, detyrohet të dorëzojë një ofertë kurdo që kërkohet nga Autoriteti Kontraktor.

**Neni 3 Kontratat në zbatim të marrëveshjes kuadër**

3.1 Kontratat do të nenshkruhen vetëm pas procesit të mini-konkursit.

**Neni 4 Procesi i mini-konkurrencës**

4.1 Procesi i mini- konkursit do të kryhet me të gjithe operatoret ekonomike, palë në marrëveshjen kuadër, kurdoherë që paraqitet nevoja për punë /mallra/shërbime për Autoritetet Kontraktore.

4.2 Autoriteti Kontraktor do të ri-hapë konkursin në bazë të kushteve të njëjta ose të

kushteve të tjera të vendosura në ftesën për ofertë, sipas përcaktimeve në dokumentat e tenderit.

4.3 Kurdoherë që paraqitet nevoja për punë/mall /shërbim Autoriteti Kontraktor duhet të përgatisë Ftesat për Oferte dhe t'ua dërgojë të gjithë operatorëve ekonomike, palë në marrëveshjen kuadër. Vlerësimi i ofertave do të bëhet sipas kritereve të përcaktuara në Ftesën për Ofertë.

**Neni 5 Kohëzgjatja e marrëveshjes kuadër**

___________________________________

**Nënshkrimet dhe datat**

| **PërKontraktuesin** | | **Për Autoritetin Kontraktues** | |
|---|---|---|---|
| **Emri :** | | **Emri:** | |
| Pozita: | | Pozita: | |
| Nënshkrimi: | | Nënshkrimi: | |
| Data: | | Data: | |
| **Vula:** | | **Vula:** | |

**Shtojca 23**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE ANULIMIT**

**1.Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor**

Emri ____________________________________________

Adresa ______________________________________________

Tel/Fax ______________________________________________

E-mail ______________________________________________

Faqja në Internet ______________________________________________

**1. Lloji i procedurës:** ________________________________________

**2. Numri i Referencës:** ____________________________

**3. Objekti i kontratës** ________________________

**4. Fondi limit** ______________________________________________

**5. Arsyet e Anulimit:**

Bazuar në Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, neni 24, pika 1:

**a)** ;
**b)** ;
**c)** ;
**ç)** ;
**d)** ;
**dh)** ;

**Etj.** _______________________________________

**6. Informacione shtesë**

___________________________________________________________________________

___________________________________________________________________________

Data e shpërndarjes së këtij njoftimi.